



UDHËZUES

PËR KUALIFIKIMET NË ARSIMIN PROFESIONAL



Центар за стручно образование и обука
Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim
Vocational Education and Training Centre



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Центар за стручно
образование и обука



Образование за вработување
во Северна Македонија

Udhëzuesi u hartua nga ekipi punues i Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim, me mbështetjen e Projektit „Arsim për punësim në Maqedoninë e Veriut“ (E4E@mk).

Pikëpamjet e shprehura në Udhëzues janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe politikat e projektit, organizatave që zbatojnë projektin dhe donatorin.

Titulli: Udhëzues për kualifikimet në arsimin profesional

Botues: Projekti „Arsim për punësim në Maqedoninë e Veriut“ (E4E@mk).

Ekipi punues:

Azra Tutiq, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Bojana Politova, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Goran Spasovski, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Ekipi më i gjerë:

Roza Arsovska, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Branko Aleksovski, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Ridvan Zeqiri, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Kontribut në hartimin e Udhëzuesit kanë dhënë edhe:

Lepa Trpçeska, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Zoran Jovçevski, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Çedomir Dimovski, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Elizabeta Jovanovska Radanoviç, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Marija Nastovska, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

Përktheu: Ali Shaini

Dizajn: Koma

Të nderuar,

Në dorë keni botimin e parë të Udhëzuesit për kualifikimet në arsimin profesional, për nxënësit e shkollave fillore. Qëllimi i tij është të paraqesë kushtet, mundësitë dhe dobitë që arsimi profesional dhe trajnimi i ofron për secilin nxënës. Njëherë, është edhe mjet për shërbimin profesional në shkollat fillore për të kryer procesin e informimit, këshillimit dhe udhëzimit si elementë të orientimit profesional të nxënësve.

Nga aspekti i përmbajtjes, Udhëzuesi është përpiluar në përputhje me gjendjen aktuale në arsimin profesional, risitë, dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe dokumentet e tjera përkatëse relevante në këtë sferë. Në të janë të përmbledhura informacione konkrete dhe detaje specifike për të gjitha drejtimet/sectorët veç e veç, kualifikimet, shkollat e mesme profesionale, mundësitë për vazhdimin e arsimit dhe për punësim / vetëpunësim.

"Udhëzuesi për kualifikimet në arsimin profesional" është i dedikuar për shërbimet profesionale të shkollave fillore mbarë vendit, por edhe për tërë kuadrin mësimor, prindërit, nxënësit dhe publikun më të gjerë profesional dhe lexues.

Ky Udhëzues është i publikuar në ueb-faqen e Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim www.csoo.edu.mk

Me respekt të sinqertë,

u. d. Drejtorja e QAPT-it,
Ardijana Isahi Palloshi


PËRMBAJTJA

faq. 3



Parathënie

faq. 6



Hyrje

faq. 8



Vendi i arsimit
profesional
në sistemin
arsimor

faq. 10

Arsimi
profesional
dhe trajnimi

faq. 13




Sektorët

faq. 14



GJEOLGJI,
XEKETARI DHE
METALURGJI

faq. 18



NDËRTIMTARI
DHE GJEODEZI

faq. 22




GRAFIKË

faq. 26



EKONOMI,
DREJTËSI
DHE TREGTI

faq. 30



ELEKTROTEKNIKË

faq. 38




SHËNDETËSI
DHE MBROJTJE
SOCIALE

faq. 44




BUJQËSI,
PESHKATARI
DHE VETERINARI

faq. 50



SHËRBIME
PERSONALE

faq. 54



MAKINERI

faq. 64



KOMUNIKACION,
TRANSPORT
DHE DEPOZITIM

faq. 70



TEKSTIL, LËKURË
DHE PRODHIME
TË NGJASHME

faq. 76




HOTELERI
DHE TURIZËM

faq. 82



KIMI DHE
TEKNOLOGJI

faq. 88



PYLLTARI DHE
PËRPUNIMI
I DRURIT

U D H Ë Z U E S P Ë R K U A L I F I K I M E T N Ë A R S I M I N P R O F E S I O N A L

HYRJE

Duke pasur parasysh tendencat më të fundit botërore dhe arritjet e tanishme industriale, ekonomike dhe tekniko-teknologjike, arsimit profesional dhe trajnimi, në botë, gjithnjë e më tepër po diferencohet si një shtytës inicial i të gjithë procesit të zhvillimit të çdo vendi. Kjo ka shkaktuar ndryshime në sistemin e arsimit profesional, që nënkupton kompetenca të reja profesionale dhe kualifikime të zbatueshme, duke kërkuar një qasje të re ndaj arsimit dhe afirmimin e përfitimeve nga arsimit profesional, si një nga shtyllat kryesore që mbështetë ekonominë e secilit vend. Ekziston një nevojë e pashmangshme për të arritur te informacionet dhe kompetencat e reja të zbatueshme në praktikë, cilësi të cilat nxënësi mund t'i përvetësojë vetëm përmes procesit të arsimit profesional dhe trajnimit. Prandaj, arsimit profesional dhe trajnimi ofron kualifikime që sigurojnë kompetenca cilësore nëpërmjet të cilave dalin gjenerata të ardhshme ekonomikisht aktive dhe të punësueshme që janë të aftë për të përmirësuar jetën në tërësi.

Duke ndjekur situatat aktuale në lidhje me politikën e regjistrimit në arsimin e mesëm, mendojmë se, nxënësit e shkollave fillore nuk kanë informacione të mjaftueshme dhe të plotë për mundësitë dhe përfitimet e ofruara nga arsimit profesional. Zgjedhja e një drejtimi / sektori, respektivisht profili arsimor / kualifikimi, duhet të jetë një vendim personal i nxënësit që do t'i sjellë satisfaksion dhe mirëqenie në të ardhmen.

Shkollat profesionale ofrojnë një shumëllojshmëri të kualifikimeve, programe mësimore dinamike dhe moderne, trajnim praktik në kompani, duke siguruar një bazë të shëndoshë dhe serioze për karrierë të mëtutjeshme të suksesshme dhe zhvillim personal të nxënësit.

Ky Udhëzues paraqet arsimin profesional si pjesë e sistemit arsimor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mundësitë që i ofron arsimit profesional, përmbledhjen dhe përshkrimin e niveleve dhe llojeve të arsimit profesional, drejtimet / sektorët në arsimin profesional, përshkrimin e kualifikimeve dhe mundësitë për punësim, shkollat e mesme profesionale në të cilat janë përfshira kualifikimet nga sektorët e ndryshëm dhe informacione të tjera që do të jenë në dobi për të gjitha palët, personat profesional, prindërit dhe nxënësit.

VENDI I ARSIMIT PROFESIONAL NË ARSIMIN PROFESIONAL

Sistemi i arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut përfshin:


- ▶ **EDUKIMIN DHE ARSIMIN PARASHKOLLOR;**
- ▶ **ARSIMIN FILLOR;**
- ▶ **ARSIMIN E MESËM, DHE**
- ▶ **ARSIMIN E LARTË.**

Arsimi zhvillohet në katër gjuhë mësimore në shkollat fillore (maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbisht) dhe në tre gjuhë mësimore në arsimin e mesëm (maqedonisht, shqip dhe turqisht).


Arsimi i mesëm është i detyrueshëm dhe falas për të gjithë nxënësit dhe realizohet nëpërmjet programeve mësimore për:

- ▶ **ARSIM GJIMNAZI;**
- ▶ **ARSIM TË MESËM ARTISTIK;**
- ▶ **ARSIM TË MESËM PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE, DHE**
- ▶ **ARSIM PROFESIONAL.**

Në skemën e dhënë janë paraqitur lidhjet funksionale sipas llojeve dhe niveleve të arsimit sipas Kornizës së Kualifikimeve të Maqedonisë (KKM), në të janë paraqitur kualifikimet në të gjitha nivelet sipas KKM-së, si dhe janë dhënë sqarime në lidhje me rrugët e lëvizjes së një personi gjatë arsimit nga ai parashkollor deri te studimet e doktoratës.



LIDHSHMËRIA FUNKSIONALE SIPAS LLOJEVE DHE NIVELEVE TË ARSIMIT SIPAS KORNIZËS SË KUALIFIKIMEVE TË MAQEDONISË



ARSIMI PROFESIONAL DHE TRAJNIMI

Arsimi profesional dhe trajnimi janë pjesë e sistemit arsimor që siguron zhvillimin individual të personit, përvetësimin e kompetencave - që janë të domosdoshme për përfshirjen e tij në tregun e punës dhe / ose vazhdimin e shkollimit. Ky lloj shkollimi përgatitë nxënësit që të jenë qytetarë të ardhshëm aktivë, të mund të vazhdojnë shkollimin e tyre dhe të aftësohen kuadro me kompetenca profesionale që duhet të plotësojnë kërkesat e tregut modern të punës, i cili është konkurrues dhe fleksibël. E gjithë kjo, bazohet në parime, siç janë: inkluziviteti, cilësia, rëndësia, punësueshmëria, ndërmarrësia dhe të ngjashme, andaj, themi që, arsimi profesional mund të përgjigjet ndaj kërkesave komplekse që vijnë nga të gjithë aktorët, pra, shoqëria, biznesi, prindërit dhe nxënësit.

Arsimi profesional dhe trajnimi realizohet përmes programeve të llojeve dhe niveleve të mëposhtme:

- ▶ **AFTËSIMI / FORMËSIMI PROFESIONAL**, zgjat një deri në dy vjet, periudhë gjatë së cilës nxënësi fiton njohuri dhe aftësi praktike. Në këtë lloj arsimit regjistrohen nxënësit me arsim fillor të përfunduar, por edhe persona me arsim fillor jo të përfunduar, të cilët duhet të kryejnë edhe arsimin fillor paralelisht. Përfundimi i këtij lloj arsimit rrumbullakohet duke dhënë provimin me të cilin nxënësve u jepet një Vërtetim për aftësim profesional, respektivisht Nivelin II (i dytë) i kualifikimeve në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK). Kjo u mundëson nxënësve të vazhdojnë arsimin e tyre në një profil / kualifikim përkatës arsimor në arsimin

profesional të profesioneve (trevjeçar), nëse ata japin provimet e kalueshmërisë ose të përfshihen në tregun e punës.

- ▶ **ARSIMI PROFESIONAL PËR PROFESIONE**, zgjat tre vjet dhe në të regjistrohen nxënës me arsim fillor të përfunduar, gjithashtu mundet të transferohen "kalojnë" edhe nxënësit me aftësim përkatës profesional të mbaruar. Përfundimi i këtij lloji arsimit rrumbullakohet duke dhënë provimin përfundimtar, ku nxënësit marrin diplomë, respektivisht Nivelin III (i tretë) i kualifikimeve, në përputhje me KKK-në. Pas përfundimit të diplomimit, nxënësi ka dy mundësi për t'u kyçur në tregun e punës ose për të vazhduar shkollimin e tij në vitin e katërt të arsimit teknik, nëse nxënësi jep (kalon) provime shtesë, ndërsa me të paktën tre vjet përvojë pune përkatëse, mund të regjistrohet në arsimin post-sekondar.
- ▶ **ARSIMI TEKNIK**, zgjat katër vjet dhe i përgatitë nxënësit për tregun e punës dhe / ose për të vazhduar shkollimin. Në arsimin teknik regjistrohen nxënësit me arsim fillor të përfunduar, ndërsa në këtë lloj arsimit mund të transferohen "kalojnë" edhe nxënësit me arsim të përfunduar profesional (arsim trevjeçar). Përfundimi i këtij lloji arsimit rrumbullakohet duke dhënë maturën shtetërore ose provimin përfundimtar. Nxënësit që kanë mbaruar këtë lloj arsimit duke dhënë maturën shtetërore marrin Diplomën e maturës shtetërore e cila u mundëson atyre që të vazhdojnë arsimin e tyre në të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Nxënësit që kanë mbaruar arsimin e tyre duke kaluar provimin përfundimtar, u jepet Diplomë e provimit përfundimtar, e cila u mundëson atyre të përfshihen në mënyrë aktive në tregun e punës. Përveç kësaj, nxënësi mund të vazhdojë shkollimin e tij në arsimin post-sekondar. Nxënësit të cilët kanë mbaruar arsimin teknik kanë mbaruar Nivelin IV (e katërt) të kualifikimeve sipas KKK-së.


► **ARSIMI POST-SEKONNDAR**, zgjat një deri në dy vjet, qëllimi i tij është t'u sigurojë nxënësve / kandidatëve njohuri të thelluara, shkathtësi dhe aftësi për të punuar me teknologji më komplekse dhe më të ndërlikuara, shërbime të specializuara me cilësi të lartë, organizim pune, funksione udhëheqëse të nivelit të parë, instruktim, mentorim, etj. Në këtë lloj arsimit regjistrohen nxënësit / kandidatët që kanë mbaruar arsimin teknik, ose kanë mbaruar arsimin profesional për profesione dhe kanë tre vjet përvojë pune përkatëse. Kandidatët që kanë mbaruar arsimin post-sekondar kanë përfunduar Nivelin e kualifikimit VB (B të pestë) sipas KKK-së.

Përmes arsimit profesional dhe trajnimit, nxënësit plotësojnë nevojat e tyre arsimore, përvetësojnë shkathtësi dhe kualifikime relevante të nevojshme për përfshirjen e tyre në sfera të ndryshme të tregut të punës, përgatiten për **iniciativë, kreativitet dhe për reagim të shpejtë ndaj ndryshimeve, për mësimin gjatë gjithë jetës, ndërmarrësi**, respektivisht inkurajohen të marrin pjesë në shkollimin e mëtutjeshëm, por gjithashtu inkurajohen të fillojnë biznesin e tyre. Plani mësimor në arsimin profesional realizohet me rreth 30 orë "ngarkesë pune" në javë për nxënësit. Arsimi profesional realizohet përmes mësimin teorik dhe ushtrimeve / mësimin praktik. Praktika feriale dhe Mësimi përmes punës te punëdhënësi paraqesin format e veçanta të mësimin përmes të cilave nxënësi përvetëson shkathtësi praktike në kushte reale, te punëdhënësi. Kjo i jep nxënësve mundësinë **për të fituar "përvojë pune" dhe të trajnohet në kohë reale** gjatë shkollimit të tyre, nga ana tjetër, punëdhënësit të njihen me punonjësit potencial dhe drejtpërdrejtë të marrin pjesë në formimin e tyre dhe përzgjedhjen e punëtorëve, tashmë të përgatitur.

Aspekti social i arsimit profesional dhe trajnimit, gjithashtu, shihet në atë se, si edukohen dhe përgatiten qytetarët novatorë, konstruktivë dhe aktivë përgjegjës për jetën personale dhe sociale, tolerancën, mirëkuptimin dhe respektin e ndërsjellë. Arsimi profesional dhe trajnimi i jep çdo individ, në shoqëri, mundësinë për të përvetësuar dhe **njohur rezultatet nga mësimnxënia** në nivelin kombëtar dhe për t'i njohur dhe pranuar ato në nivel ndërkombëtar për një **punësueshmëri dhe mobilitet** më të mirë. Kjo sigurohet me krijimin e Kornizës së Kualifikimeve të Maqedonisë (KKM) si një kornizë kompatible me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) e cila siguron transparencë dhe njohje të cilësisë së kompetencave dhe kualifikimeve të individëve të përvetësuar në nivelin evropian.

Mundësi e veçantë në arsimin profesional janë të ashtuquajturat **rrugë të hapura**, respektivisht kalueshmëria horizontale dhe vertikale. **Kalueshmëria horizontale** do të thotë që, nxënësi gjatë shkollimit mund të transferohet "kalojë" nga një lloj shkollimi në një tjetër, nga një profil arsimor / kualifikim në tjetër, madje edhe nga një drejtim / sektor në tjetër, gjithsesi, në kushte të caktuara. **Kalueshmëria vertikale** do të thotë që, pas përfundimit të çdo lloj profili / kualifikimi arsimor të nivelit më të ulët, ekziston mundësia për të vazhduar shkollimin në kualifikime më të larta në kushte të caktuara edhe gjatë shkollimit. Në këtë Udhëzues në pjesën ku janë të përshkruara kualifikimet, në mënyrë skematike janë përshkruar edhe profilet arsimore / kualifikimet të nivelit më të lartë që të mundet nxënësi të bëjë kalueshmërinë, i cili ka mbaruar profilin arsimor / kualifikimin nga niveli më i ulët. Në skemën e mëposhtme është paraqitur kalueshmëria horizontale dhe vertikale e nxënësve të cilët kanë mbaruar shkollimin e mesëm.

LËVIZJA E NXËNËSVE QË KANË MBARUAR ARSIMIN E MESËM



Skema e lëvizjes së nxënësve që kanë mbaruar shkollimin e mesëm

SEKTORËT


Të gjithë profilet arsimore / kualifikimet në arsimin profesional dhe trajnimin, duke filluar nga niveli II deri Vb nga Korniza Kombëtare e Kualifikimeve, janë të vendosura në **16 (gjashtëmbëdhjetë) sektorë të kualifikimeve në arsimin profesional**, nga të cilat, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT) është kompetente për këto **14 (katërmëdhjetë) sektorë**:

- 1.** GJELOGJI, XEHETARI DHE METALURGJI;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/geologija-rudarstvo-metalurgija/>
- 2.** NDËRTIMTARI DHE GJEODEZI;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/gradeznistvo-geodezija/>
- 3.** GRAFIKË;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/graficarstvo/>
- 4.** EKONOMI, DREJTËSI DHE TREGTI;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/ekonomija-pravo-trgovija/>
- 5.** ELEKTROTEKNIKË;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/elektrotehnika/>
- 6.** SHËNDETËSI DHE MBROJTJE SOCIALE;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/zdravstvo-socijalna-zastita/>
- 7.** BUJQËSI, PESHKATARI DHE VETERINARI;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/zemjodelstvo-ribarstvo-i-veterinarstvo/>
- 8.** SHËRBIME PERSONALE;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/licni-uslugi/>
- 9.** MAKINERI;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/masinstvo/>
- 10.** KOMUNIKACION, TRANSPORT DHE DEPOZITIM;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/soobrakaj-transport-skladiranje/>
- 11.** TEKSTIL, LËKURË DHE PRODHIME TË NGJASHME;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/tekstil-koza-slicni-proizvodi/>
- 12.** HOTELERI DHE TURIZËM;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/ugostitelstvo-turizam/>
- 13.** KIMI DHE TEKNOLOGJI;
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/hemija-tehnologija/>
- 14.** PYLLTARI DHE PËRPUNIMI I DRURIT.
<http://csoo.edu.mk/pocetna/struki/sumarstvo-obrabotka-drvo/>

1

GJEOLOGJI, XEHETARI DHE METALURGJI





*Vetëm duke kërkuar
dhe gërmuar shumë
mund të gjendet ari dhe
diamantet - njeriu mund
të gjejë çdo të vërtetë
për vete, nëse gërmon
një minierë të thellë në
vetvete!*

Gjeologjia, Xehetaria dhe Metalurgjia në sistemin arsimor paraqesin një sektor heterogjen. Ai përbëhet nga tre sektorë të pavarur, të cilët, madje, kanë edhe nënsektorët e tyre. **Gjeologjia** është shkencë për tokën. Gjeologjia, si shkencë, merret kryesisht me sferat që kanë të bëjnë me pjesët sipërfaqësore të tokës. Më konkretisht, gjeologjia studion përbërjen e kores së tokës dhe proceset që shkaktojnë ndryshime të relievit. **Xehetaria** është një degë industriale që merret me procesin e gërmimit të xeheve dhe përgatitjen e tyre për shfrytëzim të mëtutjeshëm. **Metalurgjia** është shkencë për metalet, proceset për nxjerrjen dhe përpunimin e metaleve. Metalurgjia merret me prodhimin e metaleve dhe legurave, formësimin, formimin, studimin e strukturës, përbërjes dhe vetive të metaleve.

Kualifikimet nga sektori Gjeologji, Xehetari dhe Metalurgji janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMK "Taki Daskalo" - Manastir, ShMK "Mile Janevski Cingar" - Makedonska Kamenicë, ShMK "Gjorce Petrov" - Prilep, ShMK "Naum Naumov Borçe" - Probishtip dhe ShMK "Kosta Susinov" - Radovish.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

TRE VITE

**Drejtues i
makinave
për xehe**



Drejton makineritë minerare gjatë gërmimit të lëndëve të para në miniera me eksploatim sipërfaqësor dhe nëntokësor të lëndëve të para minerale, operon me impiante të përpunimit të mineraleve, mirëmban makineritë dhe pajisjet në gjendje të mirë pune, planifikon punën e vet dhe zbaton rregulla, dispozita dhe rregullativa ligjore për mbrojtjen e mjedisit të punës dhe mjedisit jetësor.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Drejtues i makinave për xehe për eksploatim sipërfaqësor dhe Drejtues i makinave për xehe për eksploatim nëntokësor në ndërmarrje dhe/ose miniera për eksploatimin e pasurive minerare, ndërtimtari, separacione dhe sferën e metalurgjisë.

KATËR VITE

**Teknik i
gjeologjisë
dhe xehtarisë**

Përdorë metoda, instrumente, mjete dhe pajisje për të ardhur te të dhënat gjeologjike, hidro-gjeologjike dhe inxhinierike në kërkimet gjeologjike; merr pjesë në procesin e përgatitjes së shpimit gjeologjik-kërkues, shpimit hidro-gjeologjik dhe gjeomekanik, pusit gjeologjik-eksplorues, operon me pajisje dhe makina, ndjekë procedura për përgatitjen e lëndëve të para minerale, zbaton rregulla, dispozita dhe rrezultativa ligjore për mbrojtjen e mjedisit të punës dhe mjedisit jetësor.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator për gjeo-shpim, Operator për kërkime gjeoteknike dhe hidrogjeologjike, Operator për kërkime të lëndëve të para minerale, Operator për minim, Operator për përgatitje të lëndëve të para minerale, Operator për eksploatimin sipërfaqësor dhe nëntokësor, si dhe në vende tjera të punës të gjitha ndërmarrjet gjeologjike, ndërtimore dhe xeheroret ku bëhet hulumtimi dhe gërmimi i lëndëve të para minerale dhe zgjyrë.

KATËR VITE**Teknik i
metalurgjisë**


Merr pjesë në proceset teknologjike për prodhimin pirometalurgjik, hidrometalurgjik dhe elektro-metalurgjik të metaleve, në procedurat për rafinimin e metaleve të papërpunuara, në proceset për marrjen e pluhurave metalikë dhe sinterimit; administron me pajisjet, mjetet dhe agregatet në të gjitha proceset për fitimin dhe rafinimin e metaleve; llogaritë, matë, ekzaminon lëndët e para, kompletton dhe mirëmban dokumentacionin dhe regjistrimet; zbaton rregulla, dispozita dhe rregullativa ligjore për mbrojtjen e mjedisit të punës dhe mjedisit jetësor.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator për fitimin e metaleve, Operator për përpunimin e metaleve, si dhe në të gjitha vendet e tjera të punës nga sfera e metalurgjisë në prodhimin e çelikut, shkritoret dhe punëtoritë e pavarura të përpunimit të metaleve.



2

**NDËRTIMTARI
DHE GJEODEZI**



**Në një shtëpi të
ndërtuar mirë,
ndihemi bukur
dhe të sigurt!**

Ndërtimtaria është industria e ndërtimit. Ndërtimi është procedurë e ndërtimit të objekteve ndërtimore, mirëmbajtjes, riparimit dhe përmirësimit së tyre. Ndërtimi është objekt i përhershëm i palëvizshëm i bërë nga njerëzit, fillimisht (burimisht) si strehë, më vonë me nevoja të ndryshme të njerëzve me qëllime të ndryshme.

Arkitektura është proces dhe prodhim nga planifikimi, projektimi dhe ndërtimi i formës, hapësirës dhe ambientit, të cilat janë reflektime funksionale, teknike, sociale dhe kuptime estetike, duke i plotësuar principet e qëndrueshmërisë, dobisë dhe estetikës (bukurisë).

Gjeodezia është shkencë e cila merret me përmasën e tokës me qëllim të përgatitjes së shtresave gjeodezike (plane dhe harta gjeodezike) për një zonë të ndarë, për territorin e një vendi, kontinenti ose tërë rruzullit tokësor. Shtresat gjeodezike përpunohen në bazë të të dhënave të mbledhura në terren me instrumente dhe metoda të ndryshme të punës.

Kualifikimet nga sektori Ndërtimari dhe Gjeodezi janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMK "Taki Daskallo" – Manastir, ShMTK "Gostivar" – Gostivar, ShMK "28 Nëntori" - Dibër, ShMK "Orde Çopella" – Prilep, SHMQSh "Zdravko Cvetkovski"- Qyteti i Shkupit, ShMQSh "Shaip Jusufi"- Qyteti i Shkupit, ShMK "Niko Nestor"-Strugë, ShMK "Nikolla Karev"-Strumicë edhe ShMPK "Moshë Pijade"-Tetovë.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

TRE VITE

**Montues për
ndërtim të thatë**



Bën përpunime dekorative dhe përfundime mbrojtëse në lloje të ndryshme të objekteve. Përgatitë sipërfaqe të ndryshme (të drurit, të muratuara, gips pllakave, sipërfaqeve nga gipsi, betonike, sintetike, me llaç dhe metalike) para se të përdoren materialet, siç janë: ngjyra, shtresa me performanca të larta, materiale papërshkuese nga uji, materialet rezistuese ndaj zjarrit, llaçe, shellaçe, mbulesa të murosurra dhe punimet përfundimtare për mbrojtje, dekorim, mbrojtje sanitare, identifikim dhe sigurim. Bën përgatitjen përfundimtare të sipërfaqeve, ngjitjen dhe përpunimin përfundimtar të gips pllakave nga kartoni. Vendosi termoizolim dhe izolim të zërit, bën veshjen e mureve, bën - kryen sisteme të mureve ndarëse dhe muret e veshura, bën - kryen sistemet e tavaneve të lëshuara, bën veshjen e nënkulmeve dhe sistemeve të dyshemesë. E kontrollon dhe përgatitë sipërfaqen. Vendosi profilet për mbrojtjen e këndeve, i plotëson lidhjet dhe plasaritjet, përzien dhe bën përzierje që të fitohet sipërfaqe më të lëmuar. Bën përpunimin e lidhjeve të pllakave nga gips kartoni, vendos, mirëmban dhe riparon korniza këndore (lajsne) dekorative dhe mure dekorative.

KATËR VITE

**Teknik i
ndërtimtarisë**

I aftësuar për ndërtimin e objekteve të sigurta, funksionale dhe të qëndrueshme në pajtim me dokumentacionin projektues përkatës, që do të plotësojnë nevojat e tanishme dhe të ardhshme të klientëve, harton dokumentacion teknik në bazë të dokumentacionit projektues, mbledhë ofertat paramasë-parallogari nga dokumentacioni projektues, planifikon dhe përgatitë dokumentacionin teknik për kryerjen e punëve ndërtimore dhe planifikon resurse për kryerjen e punëve ndërtimore (mekanizmat ndërtimorë, puna e dorës dhe specifikimi i punëve ndërtimore). Bën mbikëqyrje mbi ndërtimin e përbashkët të punëve ndërtimore dhe bën kontrollin mbi materialet e përdorura dhe ndërtimin kualitativ në pajtim me dokumentacionin projektues. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Bashkëpunëtor për dokumentacionin teknik të punëve ndërtimore dhe Operator për kryerjen dhe kontrollin e punëve ndërtimore.

Teknik i gjeodezisë

Mbledhë të dhëna dhe të njëjtat i përpunon në aspektin numerik dhe grafik duke zbatuar instrumentet matëse gjeodezike, metodat gjeodezike të matjeve dhe teknologjinë informative, kryen matje të detajuar, mirëmban kadastrë të patundshmërisë, përdorë sistemin e informacionit kadastral-gjeodezik (SIKGJ). Harton lloje të ndryshme të elaborateve gjeodezike sipas qëllimit, përpunon, mirëmban dhe përdorë bazamentet gjeodezike në formë analoge dhe digjitale, hunjëzon dhe monitoron objektet. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Gjeodet për punë kadastrale, Gjeodet për gjeodezi inxhinierike dhe Gjeodet për urbanizëm, planifikim hapësinor dhe menaxhment.

Teknik i arkitekturës

Koton dhe vizaton detaje. Përpunon paramasë, siguron dokumentacion të përgjithshëm, konverton dokumente në PDF, fut nënshkrime elektronike, siguron çmime projektuese për përpunim të paramasës. Udhëheq dhe arkivon dokumentacionin teknik sipas standardeve dhe kërkesave të kompanisë amë, harmonizon dhe unifikon shtojca grafike e tekstuale sipas niveleve dhe fazave. Lexon dhe analizon paraqitjet tekstuale dhe grafike të dokumentacionit teknik në fushën e ndërtimit të lartë. Zbaton dinamikën e parashikuar, koordinon dhe organizon punën e brigadës së tij, zbaton aktivitete për realizimin e projektit në pajtueshmëri me teknologjinë e aprovuar të ndërtimit, kontrollon, vërteton dhe teston punimet ndërtimore për fazë ose pozicion të caktuar. Kryen kontrole të rregullta, të çrregullta dhe preventive të mjeteve, pajisjeve e makinerive ndërtimore, zbaton masat shëndetësore, siguri e mbrojtje gjatë punës, masa për mbrojtjen nga zjarri dhe masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Bashkëpunëtor në përpunimin e dokumentacionit projektues dhe Operator-Kryerës i punëve ndërtimore nga arkitektura.

Teknik disenjator për arkitekturë të brendshme


Planifikon e organizon kryerjen e pjesëve të enterierit, rekomandon zgjidhje konstruktive për kryerje të enterierit dhe përdorimin e materialeve për enterier. Përgatitë dokumentacionin teknik për enterier, matë hapësirën, vizaton skica të hapësirës së regjistruar (të matur), vizaton baza, prerje, pamje e detajet të brendshme që do të rregullohet. Përpunon 3D prezantime me softuer adekuat, përpunon paramasa dhe parallogari të materialeve të nevojshme. Kontrollon instalimin e saktë të elementeve të enterierit në përputhje me dokumentacionin projektues. Lexon dhe analizon paraqitje tekstuale dhe grafike të dokumentacionit teknik nga fusha e prodhimtarisë, rekonstruimit, konservimit dhe revitalizimit të mobilies. E zbaton dinamikën e parashikuar dhe aktivitetet për realizimin e projektit në pajtim me teknologjinë e punës ose të teknologjisë së punimit të mobilies. Kontrollon, vërteton dhe teston kapjet ndërtimore në enterierin për fazë të caktuar ose pozicion. Kryen kontrole të rregullta, çrregullta dhe preventive të mjeteve të punës dhe pajisjeve për punë dhe zbaton masat shëndetësore, siguri dhe mbrojtje gjatë punës, masa për mbrojtje nga zjarri dhe masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Operator për dizajn të arkitekturës së brendshme, përpunim dhe instalim të mobilieve dhe Bashkëpunëtor gjatë përpunimit të dokumentacionit projektues për enterier.



3


GRAFIKĚ



**Dizajni krijon kulturën,
kultura i formëson
vlerat, ndërsa vlerat
e përcaktojnë
ardhmërinë!**


Sektori i Grafikës është multidisiplinar, që do të thotë se, ai në vetvete bashkon një sërë veprimtarish. Industria grafike është përpunues, ndërsa "lënda e parë" kryesore që e përpunon është informacioni. Redaktimi tekniko-grafik dhe dizajni grafik e formësojnë informacionin, respektivisht përmbajtjes i japin formën që duhet të posedojë, si në aspektin e estetikës, etikës dhe cilësisë funksionale. Teknologjia grafike merret me prodhimin dhe shumimin e këtij informacioni. Tendencat në grafikë kanë për qëllim sigurimin e informacionit cilësor, respektivisht zgjidhjen ideore që është i besueshëm me origjinalin, në mënyrë të shpejtë dhe cilësore do të shumëkohet dhe transmetohet te konsumatori, respektivisht lexuesi.

Kualifikimet nga sektori Grafikë janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMK "Taki Daskallo" - Manastir, ShMK "Riste Risteski - Riçko"- Prilep, ShMQSH "Dimitar Vllahov" – Shkup.

**NË
KOHËZGJATE**
**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**
**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**
TRE VITE
Stampues


Menaxhon dhe mirëmban makinat e shtypjes për teknikat konvencionale dhe jokonvencionale të shtypjes; përgatitë makinën për shtypje me materialet e duhura për prodhim pas marrjes së udhëzimeve nga operatori i shtypit, përgatitë ngjyrat sipas mostrave të dhëna për shtypje, plotëson ngjyrat në enën (mjetin) për ngjyra dhe vendos materialet për shtypje në makinat e shtypjes; plotëson të dhëna për funksionimin e njësive të kontrollit të kompjuterizuar, bën kontrollin e cilësisë gjatë shtypjes, identifikon problemet dhe i korrigjon gabimet; mirëmban makinat e shtypjes në gjendje të mirë pune; aplikon teknika të ndryshme shtypjeje.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Stampues i teknikave konvencionale të shtypjes dhe Stampues i teknikave jokonvencionale të shtypjes, në ekip, në makina të mëdha të shtypshkronjave, si dhe në profesione tjera nga sfera e shtypjes.

**Përpunues i
aplikacioneve
vizuale**


Dizajnon aplikime vizuale për të përcjellë një mesazh, zakonisht për qëllime reklamimi; përgatitë dizajn vizual për lloje të ndryshme të reklamave në hapësirë të hapur, si tabela, reklama të ndritshme, postera dhe të ngjashme; përgatitë dizajnin e aplikacioneve të cilat realizohen në teknikat e shtypjes me tampon ngjyrë dhe sitës; dizajnon aplikacione të shtypjes vizuale me teknika të shtypjes digjitale.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Përpunues i aplikacioneve vizuale, Stampues i teknikave jokonvencionale të shtypjes, por edhe në vende të tjera pune nga sfera e përpunimit të aplikacioneve të ndryshme vizuale.

Teknik i grafikës

Zhvillimi i produktit grafik, nga propozimi i kopjes, përmes formës së shtypit deri te shtypja e produktit final.

Tekniku i grafikës punon në punët operative në përgatitjen e kopjeve të propozimeve dhe formave të shtypjes, në përgatitjen e makinës për shtypje dhe në procesin e shtypjes, në procedurat dhe proceset e përpunimit final të produkteve grafike, në kontrollin e proceseve të prodhimit grafik, si dhe në mirëmbajtjen e makinerive, pajisjeve dhe ambientit të punës. Bashkëpunon dhe komunikon me bashkëpunëtorë dhe klientë.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator për përgatitje grafike dhe shtypje dhe Operator për përpunimin final të produkteve grafike, si dhe në vende tjera të punës nga sfera e grafikës në shtypshkronjë për ofset, flekso, bakro, sitë edhe teknika tjera të shtypjes (shumimit), në reparte dhe njësi të specializuara për shtypje në sektorë tjerë, në ndërmarrje të specializuara për përgatitje dhe përpunim të kopjeve për kopjim dhe formave të shtypjes, në ndërmarrje të specializuara për prodhim të ambalazhit, kartonit dhe përpunimit të letrës.

Redaktor i grafikës – disenjator

Propozon zgjidhje ideore për produktin grafik dhe të njëjtin e përgatitë për shtypje.

Redaktori grafik – Disenjatori punon në punët operative të dizajnit dhe përgatitjen e zgjidhjeve ideore të produktit grafik, redaktimin teknik dhe grafik të publikimeve, në përgatitjen dhe përpunimin e propozimeve për kopje dhe formave të shtypjes, si dhe në përgatitjen teknike të materialeve grafike.

Redaktori grafik – Disenjatori, pasi të mbarojë shkollën e mesme do të jetë në gjendje të punojë në shtypshkronjë, studio dizajni, redaktim grafik të botimeve, në ndërmarrje të specializuara për përgatitje grafike dhe në vende pune të tjera nga sfera e grafikës.

4

EKONOMI,
DREJTËSI
DHE TREGTI



*Paraja rrotullon botën,
biznesi rrotullon paratë.
Besoni në veten tuaj,
kyçuni në botën e
biznesit!*

Ekonomia është një fushë e jetës shoqërore në të cilën sigurohen mjetet për jetë. Këto mjete, zakonisht, ndahen në natyrore dhe ekonomike. Të mirat natyrore janë një dhuratë e natyrës, por ato janë në sasi të vogla dhe shpesh duhet të fisnikërohen për të hyrë në konsum. Nevojat e njerëzve, në zhvillimin e sotëm, kryesisht plotësohen nga të mirat ekonomike, të cilat krijohen nga veprimi njerëzor dhe puna njerëzore. Prandaj, thuhet se, ekonomia është ekonomi ose prodhim i të mirave ekonomike. Në kushtet e tregtimit të mallrave, shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet prodhuesit, respektivisht, nga njëra anë, dhe konsumatorit të shërbimeve (blerësi, konsumatori), nga ana tjetër, paraqitet si shkëmbim i parave dhe mallit ose vetëm si shkëmbim i mallrave. Është një shkëmbim i tillë brenda të cilit qarkullimi i mallrave nga prodhimi në konsum mund të bëhet vetëm përmes ndërmjetësimit të tregut dhe të parave, domethënë, duke ndërmjetësuar aktin e shitblerjes.


Kualifikimet nga sektori Ekonomi janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMEK "Jane Sandanski" - Manastir, ShMK "Jovçe Teslickov" - Veles, ShMK "Negotino" - Vrapçishtë, ShMK "Josif Josifovski" - Gjevgjeli, ShMEK "Gostivar" - Gostivar, ShMKGj "Dobri Daskallov" - Kavadar, ShMK "Mirko Millevski" - Kërçovë, ShMK "Drita" - Kërçovë, ShMK "Lupço Santov" - Koçan, ShMK "Pero Nakov" - Kumanovë, ShMPK "Sh. Kirili dhe Metodi" - Ohër, ShMEK "Kuzman Josifovski Pitu" - Prilep, ShMK "Kosta Susinov" - Radovish, ShMQSh "Koço Racin" - Qyteti i Shkupit, ShMEJQSh "Vasill Antevski Dren" - Qyteti i Shkupit, ShMEJQSh "Arseni Jovkov" - Qyteti i Shkupit, ShMQSh "Cvetan Dimov" - Qyteti i Shkupit, ShMQSh "Shaip Jusufi" - Qyteti i Shkupit, ShMQSh "Saraj" - Qyteti i Shkupit, ShMK "Jane Sandanski" - Strumicë, ShMEK "8 Shtatori" - Tetovë, ShMK "Niko Nestor" - Strugë.

**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**


**Shitës –
referent
për shërbime
shitëse**



Pranon dhe shet produkte në shitore, bën pagesën për produktet e shitura dhe mban evidencën tregtare. Bën shitjen përmes marketingut televiziv dhe E-tregtisë. Identifikon nevojat e konsumatorit, respekton të drejtat e konsumatorit dhe detyrimet e shitësit gjatë shitjes, zbaton rregulloret për siguri dhe mbrojtje gjatë punës dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Shitës-demonstrator, Shitës – përmes marketingut televiziv, Mbikëqyrës në shitore, Shitës me pakicë, Asistent shitës, por edhe në vende tjera pune të shitjes në pajtim me kualifikimin.

TRE VITE

**Asistent-
administrator
afarist**



Planifikon, organizon dhe zbaton veprimtari në fushën e administrimit të biznesit, respektivisht realizon aktivitete nga puna në zyrë dhe komunikimit afarist në proceset e biznesit të subjekteve afariste dhe në punën e institucioneve. Aplikon dispozita ligjore, standarde dhe procedura gjatë ofrimit të shërbimeve administrative; përdorë dhe mirëmban pajisjet e zyrës; mban ditar dhe regjistër; përgatitë, krijon, depoziton dhe gjen dokumente afariste dhe informacione; përdorë të shkruarit "e verbër"; plotëson dhe përdorë instrumente në qarkullimin pagesor; aplikon komunikim adekuat afarist me shkrim dhe me gojë me kolegët, klientët dhe subjektet tjera në mjedisin e biznesit; kryen komunikim elektronik me subjektet afariste dhe institucionet; siguron zbatimin e rregulloreve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator në qendrën për konsumatorë, Operator për futjen (regjistrimin) e të dhënave, Ndihmës i referentit të sigurimeve, Ndihmës zyrtar administrativ, Agjent i logjistikës, Zyrtar i depos, si dhe në vende pune tjera të sektorit sipas kualifikimit të arritur.

Teknik i ekonomisë

Planifikon, organizon, administron dhe kryen veprimtari në punën financiare, kontabilitet, punën bankare, marketing, sigurim, punën komerciale. Monitoron ndryshimet dhe nevojat e ekonomisë brenda dhe jashtë vendit, mban komunikimin afarist, respekton normat etike, kodet, legjislacionin, standardet dhe rregulloret në këtë sferë. Kryen furnizim dhe shitje brenda dhe jashtë vendit, aktivitete bankare, sigurimesh dhe marketing, mbajtjen e evidencave të kontabilitetit dhe përgatitjen e informacioneve të kontabilitetit – dhe atij financiar.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Referent financiar, Kontabilist, Referent marketingu, Nëpunës bankar, Komercialist, Agjent sigurimesh, dhe në vende pune të tjera nga sfera e ekonomisë.

Teknik i drejtësisë

Planifikon, organizon dhe zbaton veprimtari të punës administrative-teknike, të zyrës, sekretarisë dhe punës arkivore. Ndjek rregullativën ligjore dhe zbatimin e tij në fushat përkatëse. Kryen detyra administrative dhe funksione administrative-teknike dhe ndihmëse-profesionale, organizon mbledhje dhe mbajtjen e procesverbaleve, mbajtjen e regjistrit, organizimin e ngjarjeve promovuese dhe udhëtimeve zyrtare, trajton materialin arkivor dhe dokumentar në punën zyrtare dhe arkivore, si dhe trajton çështjet gjyqësore dhe mban evidencë administrative.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Referent për çështje administrative, Arkivist, Administrator teknik, Referent gjyqësor, si dhe në vende tjera pune nga sektori në pajtim me kualifikimin.


Administrator biznesi


Kryen punë dhe detyra në fushën e punës administrative-teknike, asistim gjatë planifikimit, përgatitjes, operacionalizimit, organizimin dhe kontrollin e projekteve, marrëdhëniet me publikun dhe kontabilitetin. Kryen punë dhe detyra në përgatitjen, rregullimin, shumimin, botimin, evidentimin dhe shpërndarjen e dokumenteve, kryerjen e llogaritjeve, përpunimin e të dhënave, korrespondencën afariste, formulimin e deklaratave të shkurtra dhe asistimin gjatë aktiviteteve të personit juridik. Kryen pranimin dhe rregullimin e postës ditore, ruan dokumentacionin e brendshëm, bën përgatitjen, caktimin dhe shpërndarjen e materialeve për mbledhje dhe mbajtjen e procesverbaleve nga mbledhjet, bën pranimin dhe përcjelljen e palëve, përgjigjet thirrjeve telefonike, dërgon dhe pranon mesazhe elektronike dhe të tjera, mban dhe azhurnon listën protokollare dhe të kontakteve, merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e udhëtimeve zyrtare në vend dhe jashtë vendit, gjithashtu merr pjesë në evenimente promovuese dhe festime të ndryshme.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Administrator teknik, Referent për çështje administrative, Asistent projekti, Asistent për marrëdhënie me publikun, Kontabilist, dhe në vende tjera pune nga sektori në pajtim me kualifikimin.

5

ELEKTROTEKNIKĚ





Nikolla Tesla krijoi energjinë elektrike, Edisoni llambën Ti ç'mund të krijosh?

Elektroteknika paraqet sferë të inxhinierisë e cila përgjithësisht është e fokusuar në studimin e prodhimit, transmetimit dhe përdorimit të energjisë elektrike. Kjo është shkencë e gjerë e cila në përbërjen e vet mundëson studim të elektroenergjetikës, elektronikës, telekomunikacionit dhe teknologjisë së komunikacionit dhe informacionit.

Elektroenergjetika si pjesë e elektroteknikës merret me studimin e sistemeve elektroenergjetike në përbërje të të cilës trajtohen impiantet për prodhimin e energjisë elektrike, sistemet për transmetim të energjisë elektrike (sistemet e elektrotansmetimit), impiantet shpërndarëse, sistemet për distribuim të energjisë elektrike (sistemet elektrodistributive) dhe konsumatorët të energjisë elektrike.

Fakt i padiskutueshëm është se elektronika dhe telekomunikacioni i nënshtrohen ndryshimeve dhe rritjes së shpejtë. Si pjesë e elektronikës në suaza të elektronikës dhe telekomunikacionit trajtohen: pajisjet telekomunikuese për telefoninë mobile duke përfshirë qendrat komutuese mobile, stacionet bazë, lidhjet me mikrovalë, repetitorët, sistemet e antenave dhe pajisjet e tjera ndihmëse (furnizimi me energji elektrike, etj.), pajisjet që përbëjnë sistemet radio dhe sistemet televizive, rrjete telekomunikacioni, qarqet elektronike dhe pajisjet, si dhe pajisjet periferike.

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit janë një nga pjesët me rritje më të shpejtë dhe më dinamike të elektroteknikës që është objekt i ndryshimit me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë dhe depërtimit të teknologjisë së informacionit në të gjitha sferat e jetës njerëzore. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit, sot paraqet një lidhje midis të gjithë sektorëve të një kompanie dhe është një lloj shtytësi i veprimtarisë të përgjithshëm të kompanisë pavarësisht nëse IT është një veprimtari (biznes) parësor ose është ndihmëse (servis) për sektorët e tjerë që kanë veprimtari primare. Në suaza të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit trajtohet puna me: bazat e të dhënave, pajisjet elektronike që e përbëjnë kompjuterin në tërësi, duke përfshirë edhe pajisjet periferike, sistemet kompjuterike dhe rrjetet, robotikën, sistemet inteligjente, automatiken e procesit, ueb-programin, etj.

Zhvillimi i teknologjisë digjitale, inteligjencës artificiale, robotikës dhe automatikës do të bëjnë riorganizimin më të madh në tregun e punës, do të ketë nevojë për kuadro me profesione që lidhen me këto teknologji. Disa nga teknologjitë më domethënëse dhe trendët që janë në rritje në fushën e inxhinierisë elektrike janë: inteligjenca artificiale, robotika, realiteti virtual, automatizimi i ndërtesave dhe objekteve, automatika industriale, mbledhja, ruajtja dhe përpunimi i sasive të mëdha të të dhënave dhe humanizimi i tyre, respektivisht nxjerrja kualitative e informacionit, aplikacioneve dhe pajisjeve mobile, etj.

Kualifikimet nga sektori Elektroteknikë janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMTK "Gjorgji Naumov" – Manastir, ShMPK "Kole Nedellkovski" – Veles, ShMPT "Gostivar" – Gostivar, ShMK "Kiro Spançov Brko" – Kavadar, ShMK "Mirko Milevski" – Kërçovë, SHMK "Drita" – Kërçovë, ShMK "Gosho Vikentiev" – Koçan, ShMK "Gjorçe Petrov" – Kriva Pallankë, ShMT "Nace Bugjoni" – Kumanovë, ShMK "Sh.Kiril dhe Metodij" – Negotinë, QShME "Sh. Naum Ohridski" – Ohër, ShMK "Riste Risteski – Riçko" – Prilep, ShMK "Kosta Susinov" – Radovish, ShMQSh "Vllado Tasevski" – Shkup, QShA "Boro Petrushevski"- Shkup, ShMETQSh "Mihajlo Pupin" – Shkup, ShMK "Niko Nestor"-Strugë, ShMK "Nikolla Karev" – Strumicë, ShMPK "Moshja Pijade" – Tetovë, ShMK "Kole Nehtenin" – Shtip, ShMK "Ilinden" – Ilinden.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

**DY
VITE**


Autoelektrik




Realizon intervenim në instalimet elektrike të automjeteve, monton dhe çmonton elemente elektrike në automjete; kontrollon rregullueshmërinë e sensorëve dhe të njëjtët i rregullon; diagnostifikon dhe e rregullon sistemin për startim, ndezje, injektim, tejnxehje dhe sistemet për siguri të veturës; shfrytëzon pajisje të ndryshme, vegla, pajisje dhe materiale në procesin mirëmbajtjes dhe eliminimin e defekteve. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Autoelektrik, si dhe në vendet tjera të punës nga sfera e autoelektrikës.

**TRE
VITE**

Autoelektronik




Përpunon komplet instalime elektrike, mirëmban elemente elektrike dhe elektronike të automjeteve. Bënë auto-diagnostifikimin, i lexon gabimet dhe i eliminon defektet, e pastaj i fshinë. Kontrollon rregullueshmërinë e sensorëve dhe të njëjtat i rregullon. Gjithashtu, është i aftë që të diagnostifikon dhe rregullon (ndreqë) sistemin për startim, ndezje, injektim, tejnxehje, sistem për sigurinë e automjeteve, ABS, ASR. . . I sqaron bllok-diagramet dhe diagramet funksionale të sistemit CAN dhe aplikon diagnostifikimin në ta. Teston sistemet OBD te automjetet. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Autoelektrik ose Autoelektronik, si dhe në vende tjera pune nga sfera e kualifikimit.



Elektricitet

Realizon, servison dhe mirëmban instalime elektrike deri në 1kV në objektet dhe reparte. Monton, lidhë dhe demonton pajisje kyçëse, siguresa të instalimeve ndërprerës, njehsor, tabela shpërndarëse dhe pajisje tjera në instalime elektrike deri në 1kV. Monton, lidhë dhe demonton burime elektrike të dritave dhe ndriçimeve në përputhshmëri me kërkesat dhe nevojat e hapësirës për ndriçim. Bënë matje dhe kontroll të madhësive elektrike me instrumente matëse. Posedon aftësi praktike për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit elektrik me linja (kablo) elektro-energjetike mbi tokësore dhe nëntokësore. Realizon instalime elektrike për punë dhe menaxhimi me makina elektrike dhe reparte elektromotorë dhe realizon, servison dhe mirëmban objekte elektroenergjetike (impiante dhe linja). Zbaton dhe realizon manipulime me pajisje çmontuese në objektet elektroenergjetike. Propozon masa për përmirësimin e efikasitetit energjetik në objekte gjatë situatave të ndryshme dhe ndërmerr aktivitete dhe veprime me të cilat e zvogëlon harxhimin e energjisë elektrike. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Elektricitet për instalim dhe mirëmbajtje; Elektromontues i objekteve elektroenergjetike (impianteve dhe linjave); Elektroinstalues i instalimeve të rrymave të mëdha deri në 1 kV dhe Elektroinstalues dhe montues i pajisjeve me efikasitet energjetikë, si dhe vende tjera pune në suaza të sferës së kualifikimit.


TRE VITE



Elektromekanik për elektronikë dhe telekomunikacion


Diagnostifikon arsyen për dukuritë e defektit te pajisjet elektronike, telekomunikuese dhe aparateve. Instalon pajisje telekomunikuese dhe konstituon (llogaritë dhe përpunon) qarqe të pajisjeve elektronike. Njëhë pajisje dhe sisteme elektronike dhe e njëhë materialin, sistemin, materialin dhe elementet që shfrytëzohen gjatë përpunimit të pajisjeve dhe sistemeve elektronike. Shfrytëzon vegla dhe pajisje matëse që praktikisht zbatohen në elektroteknikë. Zbaton dhe mirëmban teknikat video dhe audio. Teston karakteristikat e pajisjeve dhe elementeve elektronike. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Elektromekanik për mjetet dhe pajisjet elektronike; Elektromekanik për pajisjet e telekomunikacionit dhe mjetet e telekomunikacionit; Elektroinstalues dhe montues për pajisjet e telekomunikacionit dhe materialeve të telekomunikacionit dhe Elektromekanik për audio dhe video teknikën, si dhe në vende tjera pune në suaza të sferës së kualifikimit.

Elektromekanik për teknikë kompjuterike dhe teknologji




Punon me zgjidhje harduerike dhe softuerike. Dizajnon dhe teston zgjidhje kompjuterike sipas nevojave të shfrytëzuesëve. Propozon dhe merrë pjesë në zhvillimin e softuerit me zbatimin e teorive dhe principeve të shkencave kompjuterike dhe analizës matematikore. Punon me pajisje periferike, duke përfshirë tastiera, ruter, printer, skaner dhe të tjera. Instalon, konfiguron dhe mirëmban rrjeta. Detekton gabime, servison kompjuter dhe pajisje kompjuterike. Zbaton procedura në programim, implementim të programit në mikrokontroller me programator. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Elektromekanik për harduerin kompjuterik dhe Elektromekanik për teknologjinë kompjuterike, si dhe në vende tjera pune nga sfera elektro-mekanike për teknikën dhe teknologjinë kompjuterike, gjithashtu edhe në vende tjera pune që janë në përputhshmëri me sferën e kualifikimit.

TRE VITE



Elektromekanik

Servison dhe mirëmban aparate shtëpiake më të vogla dhe veglave elektrike manuale, diagnostifikon shkaqet për paraqitjen e defekteve të transformatorët, makinat elektrike rotulluese me rryma alternative dhe me rryma të vazhduara dhe veglat elektrike manuale. Servison dhe mirëmban lloje të ndryshme të transformatorëve dhe makinave elektrike rotulluese të rrymave alternative dhe të rrymave të vazhduara. Përpunon dredha (pështjella), i fut dhe i lidhë dredhat për transformator, makina elektrike rotulluese të rrymave alternative dhe të vazhduara. Zbaton procedura për matje dhe testime të transformatorëve dhe makinave elektrike rotulluese të rrymave alternative dhe rrymave të vazhduara. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Elektromekanik për reparte; Elektromekanik për pajisje ftohëse dhe termike; Elektromekanik për vinklim dhe Elektromekanik për aparate dhe pajisje shtëpiake, si dhe vende tjera pune afëra e punëve elektro-mekanike për teknologji dhe teknikë kompjuterike, gjithashtu edhe në vende tjera pune që janë në përputhshmëri me sferën e kualifikimit.



TRE VITE

Elektrik- elektromontues i rrjetave elektroenergjetike

Realizon dhe mirëmban instalime elektrike të objekteve industriale dhe banesore. Realizon matje në instalime elektrike. Realizon punë për funksionimin tokëzimit dhe mbrojtjen e tokëzimit dhe rrufepritësit. Lidhë shtëpiza shpërndarëse, shtëpiza shpërndarëse matëse dhe tabela shpërndarëse me kablo dhe përçues përkatës. Monton elemente nga linja dhe rrjete mbitokësore dhe nëntokësore. Vendos, vazhdon dhe lidhë kablo energjetike. Bënë matje dhe kontroll të madhësive elektrike me instrumente matëse të ndryshme. Monton dhe çmonton elemente në transformatorë energjetikë (ETP) të tipeve të ndryshme të stacioneve të transformatorëve (TC) CH/HH dhe bëjnë verifikimin dhe inspektimin e tyre. Realizon instalime elektrike për punë dhe menaxhim me makina elektrike dhe reparte elektromotorë dhe realizon, servison dhe mirëmban objekte elektroenergjetike të tensionit të ulët dhe tensionit të lartë (impiante dhe linjave). Zbaton dhe manipulon me pajisje montuese në objekte elektroenergjetike. Propozon masa për përmirësimin e efikasitetit energjetik në objekte dhe në situata të ndryshme, si dhe i zvogëlon harxhimet të energjisë me veprime dhe aktivitete të ndryshme. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Elektromontues i rrjetave elektroenergjetike, Elektracist për instalime dhe mirëmbajtje, Elektromontues i objekteve elektroenergjetike (impianteve dhe linjave); Elektroinstalues i instalimeve të rrymave të larta 1kV dhe elektroinstalues dhe montues të pajisjeve me efikasitet energjetik, si edhe në vende tjera pune në përputhshmëri me sferën e kualifikimit.

KATËR VITE

Elektroteknik për teknikë kompjuterike dhe automatikë

Bënë intervenime të natyrës elektroteknike të IT pajisjeve dhe proceseve të automatizuara; programon sisteme kompjuterike dhe procese të automatizuara duke aplikuar gjuhët programore; punon në mënyrë të pavarur me bazë të të dhënave; instalon, mirëmban dhe servison kompjuter, rrjete kompjuterike dhe pajisje kompjuterike periferike; punon me sisteme inteligjente dhe robot; realizon intervenime gjatë ekzekutimit vizual dhe programor të ueb-faqeve dhe zbaton standarde gjatë punës me teknologji kompjuterike, etj. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë në mjedise të ndryshme punuese, siç janë: industria e IT, rrjetave kompjuterike, sisteme inteligjente dhe robotike, ueb-dizajn, prodhim, transmetim dhe distribuim të energjisë elektrike, ndriçim të sipërfaqeve të mbyllura dhe të hapura, reparte industriale të kompjuterizuara, objekte banesore, institucione për shërbime publike, medime, institucione për turizëm, hoteleri, arsim, shkencë, shëndetësi, bujqësi, vende pune të tjera, si dhe të zhvillon biznes të vetin. Gjithashtu, mund të kryejë detyra pune, si: Teknik për robotikë dhe sisteme inteligjente; Operator i bazës së të dhënave; Teknik i automatikës procesuese; Teknik i elektronikës për kompjuter; Teknik i sistemeve kompjuterike dhe rrjeteve; Teknik i uebit dhe Teknik i teknologjisë së informatikës dhe komunikimit (TIK) për mbështetje të shfrytëzuesëve, si dhe në vende pune të tjera në përputhshmëri me sferën e kualifikimit.

Elektroteknik për elektronikë dhe telekomunikacion

Monton, instalon, mirëmban, servison dhe menaxhon sistemet automatike dhe të kontrollit, audio dhe video pajisjet, pajisjet telekomunikuese dhe rrjetet e telefonisë mobile. Ndjek dhe optimizon punën, zgjidhë probleme, kontrollon kualitete dhe aplikon masa mbrojtëse dhe të sigurisë gjatë punës dhe respekton mbrojtjen e mjedisit të jetësor. Duke përvetësuar kualifikimin Elektroteknik për elektronikë dhe telekomunikacion, nxënësi do të mund të punojë në mjedise pune siç janë: Operator i telefonisë mobile, Operator i telekomunikacionit, në shtëpi dhe stacione radio televizive, medime, institucione për shërbime publike, kompani për komunikacion dhe transport, kompani për prodhim, transmetim dhe distribuim të të dhënave elektronike, institucione shëndetësore dhe sociale, institucione arsimore dhe shkencore, institucione të turizmit dhe hotelarisë, kompani për bujqësi dhe kopshtari, industrinë e filmit, etj., gjithashtu, mund të zhvillojë dhe biznes personal. Njëherë, do të mund të realizojë detyra pune, si: Teknik për elementet, aparate dhe pajisje elektronike, Elektroteknik për sisteme automatike dhe të kontrollit; Elektroteknik për pajisjet radio televizive; Elektroteknik për pajisjet dhe rrjetet e telekomunikacionit; Elektroteknik për telefoninë mobile; Incizues i figurës dhe Montues i figurës dhe tonit, si edhe në vende tjera pune që janë në përputhshmëri me afërën e kualifikimit.

Elektroteknik – Teknik i energjetikës

Zbulon defekte dhe bënë intervenime nga natyra elektrike dhe joelektrike të instalimeve elektrike dhe ndriçime, kontrollon dhe analizon parametra dhe të dhëna të fituara nga instrumentet matëse për shkak të menaxhimit dhe rregullimit në elektroenergjetikë, menaxhon, kontrollon dhe mirëmban centralet elektrike, impiantet elektroenergjetike dhe repartet elektromotore, realizon operacione të rrjetave elektroenergjetike të tensioneve të ulëta dhe të tensioneve të larta. Servison, mirëmban dhe ndreq aparatet shtëpiake dhe pajisjeve. Duke përvetësuar kualifikimin "Elektroteknik – energjetik", nxënësi do të mund të punojë në mjedise pune të ndryshme, siç janë: prodhimtari, transmetim dhe distribuim të energjisë elektrike, ndriçim të sipërfaqeve të hapura dhe të mbyllura, reparte industriale, objekte banesore, institucione për shërbime publike, servis për aparatet shtëpiake, medime, institucione për turizëm, hoteleri, arsim, shkencë, shëndetësi, bujqësi e të tjera, si edhe të zhvillojë biznes personal. Gjithashtu, do të mund të bëjë detyra pune si: Elektroteknik për instalime elektrike dhe ndriçim, Elektroteknik për komunikim, matje dhe menaxhim në elektroenergjetikë; Elektroteknik për prodhim, transmetim dhe distribuim të energjisë elektrike; Operator të makinave elektrike dhe reparteve elektromotore dhe Operator i pajisjeve dhe aparateve për amvisëri dhe reparte, si edhe vende pune të tjera në përputhje me kualifikimin.

KATËR VITE**Teknik për
mekatronikë
industriale**


Bënë intervenime të sistemeve mekatronike të natyrës elektroteknike dhe makinerike, zbaton pajisje TI në procese të automatizuara; programon sisteme kompjuterike dhe procese të automatizuara duke zbatuar gjuhët programore; instalon, mirëmban kompjuterë dhe pajisje kompjuterike periferike; punon me sisteme inteligjente dhe robotë; realizon intervenime në procese me rregullim automatikë dhe aplikon standarde gjatë punës me teknologji kompjuterike dhe të tjera. Propozon masa për përmirësimin e efikasitetit energjetik në objekte gjatë situatave të ndryshme dhe e zvogëlon harxhimin e energjisë në veprime dhe aktivitete të ndryshme, siguria në vendet e punës dhe procedurat për sigurinë dhe manipulim i drejt në sistemet mekatronike.

Duke përvetësuar këtë kualifikim, nxënësi do të mund të punojë në vende pune të ndryshme, siç janë: industria e IT, sisteme inteligjente dhe robotikë, reparte industriale të automatizuara, objekte banesore, institucione për shërbime publike, medime, institucione për turizëm, hoteleri, arsim, shkencë, arsim, bujqësi dhe të tjera, si edhe të zhvilloi biznes personal. Gjithashtu, do të mund të realizojë edhe detyra, si: Elektroteknik për sisteme automatike dhe të kontrollit, Teknik të automatikës së procesit, Teknik për robotikë dhe sisteme inteligjente, Elektroteknik për komunikim, matje dhe menaxhim në elektroenergjetikë, Operator i makinave elektrike dhe reparte elektromotore, Operator të sistemeve të komanduara me kompjuter, Operator i teknologjisë së përpunimit të metaleve me deformime dhe gdhendje (prerje) dhe në vende pune të tjera në përputhshmëri me sferën e kualifikimit.

A top-down view of medical supplies on a blue surface. On the left is a white surgical mask. In the center is a white plastic dropper bottle. To its right is a syringe with a needle, containing a small amount of dark liquid. On the far right is a blister pack containing several light green capsules. The number '6' is overlaid in the top left corner.

6

**SHËNDETËSI
DHE MBROJTJE
SOCIALE**



**Kujdesi për shëndetin
është një udhërrëfyes
për një jetë më të
gjatë dhe më të mirë!**

Veprimtaria shëndetësore është me interes publik dhe realizohet si shërbim publik që siguron kujdesin shëndetësor. Ajo përfshin masat, aktivitetet dhe procedurat për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit, për parandalimin, zbulimin e hershëm dhe zhdukjen e sëmundjeve, dëmtimeve dhe çrregullimeve të tjera shëndetësore të shkaktuara nga ndikimi i punës dhe mjedisit, për kurim efikas dhe në kohë të duhur, si dhe për kujdesin shëndetësor dhe rehabilitimin.

Kualifikimet nga sektori Shëndetësi dhe Mbrojtje sociale janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMMK „D-r. Jovan Kallauzi“-Manastir, ShMK „Bogdanci“-Bogdanci, ShMPK „Dimitrija Çupovski“-Veles, ShMMK „Gostivar“-Gostivar, ShMBPK „Gjorçe Petrov“-Kavadar, ShMK „Mirko Mileski“-Kërçovë, ShMK „Drita“-Kërçovë, OSZ „Nace Bugjoni“-Kumanovë, ShMPK „Sh.Kiril dhe Metodij“-Ohër, ShMK „Gjorçe Petrov“- Prilep, ShMMQSh „D-r. Pançe Karagjozov“ – Qyteti i Shkupit, ShMQSh „Cvetan Dimov“ – Qyteti i Shkupit, ShMQSh „Marija Kiri Skllodovska“ – Qyteti i Shkupit, ShMQSh „Shaip Jusufi“, - Qyteti i Shkupit, ShMK „Niko Nestor“ – Strugë , ShMQSh „Dimitar Vllahov“ – Strumicë, ShMMK „Nikolla Shtejn“ – Tetovë, ShMK „Jane Sandanski“ – Shtip.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

TRE VITE

**Ndihmës-
përkujdesës**



Siguron kujdes bazë me cilësi të lartë dhe ndihmë të shpejtë të personave, në formë të detyrave mirë të definuara, përsëritëse dhe rutine në institucionin spitalor dhe në kushte shtëpiake. Realizon dhe merr pjesë në aktivitete lidhur me mirëmbajtjen e higjienës, të ushqyerit dhe preventivës ndaj parregullsiive. Kryen punë lidhur me shtratin spitalor dhe atë shtëpiak, çfarëdo lloj bartje dhe merr masa ndaj infektiveve në kushte spitalore dhe shtëpiake. Percepton dhe ndjek gjendjet elementare patologjike, sëmundjet, ndryshimet psikofizike dhe vdekjet, gjithashtu zhvillon në mënyrë të duhur veprimtaritë mjekësore sipas urdhrit (rregullit).

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Nëpunës shëndetësor, Përkujdesës ndaj njerëzve të moshuar dhe në vende të tjera të punës sipas kualifikimit.

KATËR VITE

**Motër
medicinale**

Zbaton kujdes të përgjithshëm dhe të veçantë shëndetësor me qëllime parandaluese tek popullsia e shëndoshë, si dhe tek të sëmurët me qëllime diagnostikuese, terapeutike dhe rehabilituese në mbrojtjen shëndetësore primare, sekondare dhe terciare. Organizon dhe realizon kontroll preventive dhe sistematike, vizitë shtëpiake, vaksinim, kujdes të përgjithshëm dhe të veçantë të pacientit si një pjesë e grupit shëndetësor. Gjatë kësaj, përdorë, deponon dhe aplikon gjak, derivate të gjakut dhe medikamente, merr materiale biologjike për diagnostikim sipas rregullave të dhëna nga mjeku. Operon me pajisje themelore mjekësore dhe instrumente, materiale mjekësore dhe mjetet për mbrojtje. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Motër medicinale dhe në vende tjera pune sipas kualifikimit përkatës.

**Teknik
fizioterapeut**

Merr pjesë në ruajtjen e shëndetit, edukimin shëndetësor dhe rehabilitimin e pacientit, në mbrojtjen shëndetësore primare, sekondare dhe terciare. E planifikon dhe e organizon punën e vet përmes përgatitjes së hapësirës, pacientit, pajisjeve, instrumenteve, materialeve dhe mjeteve ndihmëse për rehabilitim mjekësor. Përdorë tretmanë fizikale, masazhe, fitnes dhe ushtrime kineziterapi, duke u kujdesur për gjendjen e përgjithshme dhe përparimin e pacientit, për të cilët në mënyrë precize dhe të rregullt mban evidencë për dokumentacionin mjekësor. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Teknik fizioterapeut dhe në vende tjera të punës sipas kualifikimit përkatës.

**Asistent
dental**

Kryen detyra në zbatimin e procedurave diagnostikuese dhe terapeutike në fushën e mjekësisë dentale. Vepron në kuadër të detyrave të tij, duke i respektuar standardet dhe protokollet ekzistuese. Administron dhe përpunon të dhënat për pacientin, realizon komunikim me të gjithë subjektet të kyçura në sistemin e mbrojtjes shëndetësore duke i respektuar parimet e etikës dhe kulturës afariste, kujdeset për zbatimin e parimeve të punës aseptike në ordinancën stomatologjike dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga të gjithë faktorët negativ. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Asistent dental dhe në vende tjera të punës sipas kualifikimit përkatës.

**Teknik
farmaceutik**

Bën përgatitjen e barërave dhe komponimeve tjera farmaceutike me ndihmën e farmacistit, bën porosi, pranim, shënim, defektim, deponim dhe ruajtjen e barërave, lëndëve të para, ambalazhit dhe rezervave tjera, merr pjesë në farmakovigilancë, hulumtime, kontrole dhe hulumtime të cilësisë, shitjen dhe dhënien e rekomandimeve: OTS preparate, suplemente, çaje, dietetikë, material sintetike, pajisje dhe instrumente mjekësore, etj. Evidenton, përpunon, analizon dhe dokumenton të dhënat si dhe bën kryerjen e llogaritjeve, në përputhje me detyrat punuese. Radhit dhe bën mbikëqyrjen mbi punëtorët, mbi fazat teknologjike në prodhimtarinë farmaceutike dhe kozmetike, siguron pastërtinë dhe sigurinë e aparaturës dhe inventarit, raporton për parregullsitë dhe zgjidhë problemet në vendin e punës, me përdorimin e standardeve dhe rregullave përkatëse, duke i respektuar parimet për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit jetësor. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Teknik farmaceutik dhe në vende tjera të punës sipas kualifikimit përkatës.

Motër gjinekologjike- obstetike

Përdor përkujdesjen shëndetësore në mbrojtjen shëndetësore primare, sekondare dhe terciare tek popullsia femërore. Planifikon, organizon dhe realizon manipulimet diagnostike dhe terapeutike, si pjesë e grupit shëndetësor. Pjesëmarrja aktive në procesin e mbrojtjes parenatale, perinatale dhe postnatale të nënës dhe foshnjës së porsalindur. Ndikon në nivelin e edukimit shëndetësor të popullsisë femërore me qëllim të preventivës së SPB dhe sëmundjeve malinje. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi/nxënësja do të mund të punojë, si: Motër gjinekologjike-obstetike dhe në vende tjera të punës sipas kualifikimit përkatës.

Teknik laborant- sanitar mjekësor

Realizon hulumtime të materialit biologjik për vërtetimin e gjendjes shëndetësore të popullatës, si dhe hulumtime të ushqimit, ujit, mbeturinat e materieve dhe lëndëve për përdorim e përgjithshëm dhe zbaton metoda të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit. Përdorë metoda dhe aparatura bashkëkohore për vërtetimin e gjendjes shëndetësore, diagnostikimit dhe ndjekjen e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit kolektiv dhe pengimin e zgjerimit të sëmundjeve. Merr pjesë në planifikimin, organizimin dhe realizimin e punës në laborator dhe në terren, ku plotëson dokumentacionin punues. Merr pjesë edhe në edukimin shëndetësor për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit, si dhe preventivës së sëmundjeve. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Teknik laborant-sanitar mjekësor dhe në vende tjera të punës sipas kualifikimit përkatës.

Teknik dhëmbësh


Përpunon konstruksione fikse – protetike, punime mobile protetike, aparate ortopedike mobile, konstruksione protetike të kombinuara. E planifikon dhe organizon punën në laboratorin teknik- dhëmbësh, i koordinon aktivitetet me grupin stomatologjik. Përgatit aparaturë, instrumente dhe materiale për punime përkatëse, mban dokumentacionin dhe evidencën mjekësore. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Teknik dhëmbësh dhe në vende tjera të punës sipas kualifikimit përkatës.



7

**BUJQËSI,
PESHKATARI
DHE VETERINARI**





Bujqësia është si forca e Arkimedit, megjithëse nuk e lëviz botën, mund ta mbushë atë me bollëk, shëndet të mirë dhe njerëz të lumtur!

Bujqësia (e quajtur edhe bujqësi, lavërtari) paraqet drejtim themelor ekonomik (primar) dhe veprimtari e cila paraqet procesin e prodhimit të ushqimit, ushqimit për kafshë, fijeve, lëndën e parë për përpunimin industrial dhe produkte tjera të nevojshme nëpërmjet kultivimit të bimëve të caktuara dhe kafshët shtëpiake. Me nocionin **Bujqësi** quhen grupi i madh i veprimtarive agrare të cilët fillimisht i përfshijnë: lavërtarinë, blegtorinë, vreshtarinë-pemëtarinë. Agronomia është grumbull shkencash, të cilët studiojnë mënyrën e prodhimit të bujqësore dhe ekonomizimin, si dhe e hulumtojnë shtetet e dryshme në nivel të bimëve të kultivuara –kushteve ekologjike abiotike-kushteve ekologjike biotike.

Peshkimi dhe peshkataria është drejtim ekonomik që ka për detyrë kultivimin, gjuajtjen (peshkimin) dhe përpunimin e peshkut.

Veterinaria është drejtim i medicinës që merret me preventivë, diagnostifikim dhe shërim të sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve të kafshët.

Kualifikimet nga sektori Bujqësi, Peshkataria dhe Veterinaria janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMBK "Kuzman Shapkarev" – Manastir, ShMK "Goce Dellqev" – Vallandovë, ShMBPK "Gjorçe Petrov" – Kavadar, ShMPK "Kiro Burnaz" – Kumanovë, ShMK "Orde Çopella" – Prilep, ShMK "Car Samoill" – Resnjë, ShMK" Koço Racin" – Sveti Nikollë, ShMQSh "Braça Milladinovci" – Qyteti i Shkupit, ShMK "Dimitar Vllahov" – Strumicë, ShMPK "Mosha Pijade" – Tetovë.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

TRE VITE

Kopshtar-lulëtar



Kryen operacione për planifikimin dhe prodhimtarinë, përgatitjen e tokës për mbjellje dhe rimbjellje të kulturave perimore dhe lulëtare, kultivimin dhe përkujdesjen e fidanëve dhe rasatit, mbjelljen direkte, rimbjelljen dhe përkujdesjen e kulturave, respektivisht rasatit me kultura perimore dhe lulëtare. Në prodhimtarinë kopshtare dhe prodhimin e luleve, ai bën mbrojtjen e fidanëve, kulturave dhe plantacioneve, shfrytëzimi racional i materialit dhe kohës gjatë kultivimit të kulturave perimore dhe luleve, vjeljen, transportin, kalibrimin, radhitjen dhe magazinimin e prodhimeve perimore dhe luleve dhe mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit jetësor.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Prodhues i luleve (Lulëtar) dhe Prodhues i kulturave kopshtare (Kopshtar)

KATËR VITE

Agroteknik

Kontrollon operacione për përdorimin e teknikave themelore gjatë punës në lavërtari, kopshtari, lulëtar, prodhimtari vreshtaro-pemtare, në mënyrë të rregullt përgatitë makinat bujqësore dhe materiale për prodhimtari bimore, aplikon sistemet për punimin e sipërfaqes për prodhimin e kulturave bujqësore, mënyrat dhe teknikat e mbjelljes, rimbjelljes dhe mbjelljes me rasat, masat për përkujdesje të kulturave bujqësore. Aplikon principet e prodhimtarisë bujqësore organike dhe mundësitë për kalimin nga prodhimtaria konvencionale në prodhimtarinë bujqësore organike. Realizon teknologji të caktuara për punë, kontroll të kushteve zoohigjienike dhe mikroklimatike të objekteve për ruajtjen e kafshëve. Kontrollon masa përkatëse për ushqimet e të gjitha llojeve dhe kategorive të kafshëve, laktacioni, rritjen dhe mbajtjen, kushtet për magazinim të sigurt dhe ruajtjen e prodhimeve nga prodhimtaria blegtorale.

**Teknik i
mjekësisë
veterinare**

Merr pjesë në përpunimin e planit për punë, marrjen e mostrave për analiza nga prodhimet blegtorale dhe ushqimin e kafshëve. Udhëheq regjistër evidentues të kafshëve, për mbarësimin e kafshëve dhe aplikimin e principeve të prodhimitarisë blegtorale organike. Kontrollon operacionet për përdorimin e teknikave elementare gjatë punës me mekanizim bujqësor.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator për prodhimtari bimore bujqësore, Operator për prodhimtari blegtorale, Operator për mekanizim bujqësor, por edhe në profesione tjera në pajtim me kualifikimin e arritur.

Planifikon dhe organizon veprimtari, në mënyrë të pavarur ose nën mbikëqyrje dhe me urdhër të MMV (Mjek i Mjekësisë Veterinare). Ndhmon në ekzaminimin, diagnostikimin dhe kurimin e kafshëve. Merr pjesë në testet laboratorike dhe kontrollin e ushqimit me origjinë shtazore. Përgatitë dhe ushqen kafshët shtëpiake, zbaton masa parandaluese, zooteknike dhe zoohigjienike për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve. Mban shënime veterinare, kryen mbarësim artificial, shënon kafshë dhe punë të tjera teknike që lidhen me shëndetin e kafshëve, në përputhje me rregulloret ligjore për luftën kundër sëmundjeve infektive të kafshëve që rrezikojnë të gjithë vendin, si dhe shëndetin e kafshëve dhe njerëzve. Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator në medicinën veterinare, Operator për prodhimtari blegtorale, por edhe në profesione tjera në pajtim me kualifikimin e arritur.

**Teknik i
fitomedicinës**

Njeh dëmtuesit dhe sëmundjet e kulturave; zbaton masat e mbrojtjes së bimëve; harton plan për mbrojtjen e kulturave individuale; përgatitë produkte për mbrojtjen e bimëve; jep këshilla për mbrojtjen e bimëve dhe aplikimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve; bën punë në barnatore bujqësore për shitjen e preparateve për mbrojtjen e bimëve, si dhe bën parashikimin e paraqitjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve të caktuar.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator për mbrojtjen e bimëve, Operator për prodhimtarinë bimore bujqësore, por edhe në profesione tjera në pajtim me kualifikimin e arritur.

Teknik i agromenaxhmentit

Planifikon, organizon dhe kontrollon operacionet për të aplikuar teknikat themelore gjatë punës në fermë. Përgatitë planin e prodhimit, përcakton madhësinë dhe strukturën e oborrit komercial dhe të sipërfaqes së prodhimit, makineritë e nevojshme, pajisjet dhe mjetet, zbaton masa agroteknike dhe zooteknike në fermë dhe furnizohet me lëndë të para dhe mjete për punë. Planifikon, organizon dhe kontrollon operacionet për shitjen e produkteve bujqësore, për prodhimin e produkteve bujqësore dhe përpunimit të tyre. Harton plan për plasmanin e produkteve bujqësore dhe prodhimeve të ngjashme, formon çmimin e shitjes, zgjedh ambalazhin e duhur. Harton plan për promovimin dhe avancimin e shitjes. Zbaton parimet e praktikës së mirë bujqësore, standardet HACCP dhe prodhimin bujqësor-organik.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator për menaxhimin e fermës, Operator për marketing të prodhimeve bujqësore dhe shërbimeve, Operator për prodhimtari bimore, Operator për prodhimtari blegtorale, Operator për mekanizim bujqësor, por edhe në profesione tjera në pajtim me kualifikimin e arritur.



8



**SHËRBIME
PERSONALE**

Kujdesi për lëkurën dhe dukjen estetike, nevojë për secilin njeri!


Sektori i Shërbimeve personale përbëhet nga nënsektorët: kozmetika, floktaria dhe optika. Sot, termi "kozmetikë" nënkupton një sërë aktivitete që synojnë kujdesin dhe bukurinë e lëkurës, ndërsa "kozmetologjia" përfshin të gjitha aktivitetet që lidhen me kozmetikën. Kozmetologjia është një disiplinë shkencore e cila studion përbërjen, teknologjinë e prodhimit, vetitë, veprimin dhe aplikimin e preparateve të kozmetikës. Floktaria përfshin detyrat që lidhen me kujdesin dhe stilimin estetik të burrave dhe grave. Optika është një pjesë e fizikës që studion fenomenet e dritës, ligjet e tyre, natyrën e dritës dhe proceset e bashkëveprimit të saj me substancën. Optika merret vetëm me një pjesë të fizikës - Optikën gjeometrike.

Kualifikimet nga sektori i Shërbimeve personale janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMK "Taki Daskallo" – Manastir, ShMMK "D-r. Jovan Kallauzi" – Manastir, ShMPK "Dimitrija Çupovski" – Veles, ShMTK "Gostivar" – Gostivar, ShMK "Drita" – Kërçovë, ShMPK "Kiro Burnaz" – Kumanovë, QShME "Sh. Naum Ohridski" – Ohër, ShMK "Gjorçe Petrov" – Prilep, ShMK "Orde Çopella"- Prilep, ShMK "Naum Naumovski – Borçe" - Probishtip, ShMQSh "Marija Kiri Sklodovska" – Qytetit i Shkupit, ShMQSh "Dimitar Vllahov" – Qytetit i Shkupit, ShMQSh "Shaip Jusufi" – Qytetit i Shkupit, ShMMK „Nikolla Shtejn” – Tetovë.

**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**




Floktar

Bën larjen dhe kujdesin e flokëve, shkurton flokët, bën frizura, ngjyrosë, bën zbardhjen e flokëve, nuancon, formon flokët duke aplikuar teknika të ndryshme të punës, përdorë produktet e parukerisë, bën zgjatjen e flokëve, si dhe bën rruajtjen e mjekrës, mustaqeve dhe zylyfeve.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit. Nxënësi mund të punojë, si: Floktar te ndonjë punëdhënës ose të fillojë biznes personal.

TRE VITE



**Estetist për
kujdesin e duarve
dhe këmbëve**

Dekoron thonjtë e duarve dhe këmbëve me teknika të ndryshme të llakimit: teknikë klasike, pikturë, dekorime, manikyr francez, si dhe lustrim të thonjve. Aplikon procedurat për kujdesin estetik të duarve dhe këmbëve. Kryen detyra në fushën e kujdesit estetik të duarve dhe këmbëve. Specifikon kundërrindikacionet për trajtim të caktuar kozmetik. Respekton kriteret estetike në drejtim. Komunikon verbalisht dhe joverbalisht me dhe pa përdorimin e mjeteve moderne të komunikimit dhe teknologjisë kompjuterike. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Manikyr-Pedikyr, si dhe profesione të tjera të lidhura me sektorin sipas kualifikimit të arritur ose duke filluar biznes personal.

Teknik për kujdes kozmetik dhe bukuri

Në mënyrë të pavarur planifikon dhe organizon punën në veprimtarinë e kozmetikës, respektivisht bën përgatitje personale, përgatitjen e vendit të punës dhe klientit, priten dhe këshillimin e klientit, zgjedhë dhe zbaton kujdesin për fytyrën dhe trajtimet e trupit duke përdorur një larmi teknikash masazhesh, trajtimet e formësimit dhe errësimit të trupit, përdorimin e përgatitjeve dhe aparateve në trajtimet: manikyr, pedikyr, shminkim dhe aplikimin e kriterëve estetike në harmonizimin e shminkimit, frizurës dhe dukjes së klientit. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Stilist-Estetist, Masazhist për masazh kozmetike, uelnes (wellness) dhe spa, Teknik i kozmetikës, si dhe në profesione tjera të ngjashme, në pajtim me kualifikimin e arritur ose duke filluar biznes personal.


Teknik i optikës së syve

Në mënyrë të pavarur matë dioptrinë e qelqit optik dhe thjerrzën e kontaktit, përpunon, riparon dhe shet lloje të ndryshme të syzeve si ndihmë optike ose detaje të modës me ndihmën e optometristit ose oftalmologut gjatë matjes e parametrave të shikimit me kërkesë të klientit. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Teknik i optikës, Bashkëpunëtor gjatë matjes për korrigjimin e shikimit dhe në profesione tjera të ngjashme, në pajtim me kualifikimin e arritur.

9

MAKINERI





Ne të gjithë e dimë se çfarë kanë bërë makinat për njerëzimin, por askush nuk e di se Ti çfarë mund të bësh për zhvillimin e makinerisë!

Makineria paraqet lëmi në inxhinieri që përfshinë aplikimin e ligjeve të fizikës në procesin e analizës, projektimit, përpunimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve mekanike. Makineria kërkon njohjen solide të koncepteve themelore si që janë mekanika, termodinamika, mekanika e fluideve, shkencë mbi materialet dhe teknologjia e përpunimit të materialeve. Makineria ka aplikim të gjerë në prodhimtarinë e automjeteve, aeroplanëve, sistemeve për ftohje dhe ngrohje, përpunimin e kapaciteteve industriale, pajisjeve dhe makinave. Ajo është një ndër disiplinat më të vjetra dhe më të gjëra në inxhinieri.

Kualifikimet nga sektori Makineri janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMTK " Gjorgji Naumov" – Manastir, ShMPK "Kole Nedellkovski" – Veles, ShMK "Vanço Prke" – Vinicë, SHMK "Josif Josifovski" – Gjevgjeli, ShMTK "Gostivar" – Gostivar, ShMK "Kiro Spanxhov Brko" – Kavadar, ShMK "Mirko Milevski" – Kërçovë, ShMK "Drita" – Kërçovë, ShMK "Gosho Vikentiev" – Koçanë, ShMK "Gjorçe Petrov" – Kriva Pallankë, ShMPK "Kiro Burnaz" – Kumanovë, ShMT "Nace Bugjoni" – Kumanovë, QShME "Sh. Naum Ohridski" – Ohër, ShMK "Riste Risteski – Riçko" – Prilep, ShMK "Naum Naumovski – Borçe" – Probishtip, ShMK "Koço Racin"- Sveti Nikollë, ShMQSh "8 Shtatori" – Shkup, ShMQSH "Vllado Tasevski"- Qyteti i Shkupit," QShA "Boro Petrushevski"- Qyteti i Shkupit, ShMK "Nikolla Karev" – Strumicë, ShMPK "Mosha Pijade" – Tetovë, ShMK "Kole Nehtenin" – Shtip.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

**TRE
VITE**


**Makinist për
stabilimente
energjetike**



Operon dhe mirëmban stabilimentet energjetike, stabilimentet kompresuese dhe ftohëse, stabilimentet termoenergjetike, stabilimentet hidropneumatike. Merr pjesë në përgatitjen e stabilimentit dhe lëshimin në punë. Përcjellë, kontrollon dhe përshtatë parametrat e stabilimentit sipas udhëzimit të dhënë. Monton dhe demonton nëntërësi dhe tërësi jo shumë të komplikuar. Riparon pjesë më të thjeshta dhe zëvendëson pjesët e konsumuara dhe pjesët e dëmtuara në stabilimentet energjetike. Në mënyrë të drejtë operon dhe mirëmban veglat, makinat dhe pajisjet për punë.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Makinist për termostabilimente, Makinist për stabilimente hidropneumatike, si dhe profesionet tjera në përputhje me kualifikimet e përvetësuara (arritura).


Saldues



I aftësuar për të prerë drejtë dhe punojë pjesët me saldim, hark elektrik dhe me procedurën e gazit, të saldojë me hark elektrik me anë të dorës, të saldojë me hark elektrik nën mbrojtjen e gazeve inerte. Personi është i aftësuar të operojë dhe të mirëmbajë veglat, aparatet dhe pajisjet për saldim.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Saldues në industrinë e automjeteve, detare, transportuese, prodhimtarinë e përgjithshme, ndërtimtari dhe shumë lëmi të tjera.

Automekanik




Mirëmban dhe riparon automjetet e lehta motorike, detajisht dhe drejtë i demonton dhe monton motorët dhe pjesët përbërëse të motorit me djegie të brendshme, e kontrollon punën, mirëmban dhe i largon parregullsitë e pjesëve të lëvizshme dhe të palëvizshme të motorit, mangësitë e mekanizmit të sistemit të motorit, mirëmban, servison dhe riparon pajisjet elektrike, sistemin për furnizim, lyerje dhe ftohje.

Mirëmban, servison, riparon parregullsitë dhe ndërron akumulatorin (baterinë), alternatorin, starterin dhe pajisjet tjera elektrike të automjetit dhe në transmetuesin e mekanizmit, ndërron pneumatikët dhe balancon rrotat, mirëmban dhe ndërron pjesët e sistemit për siguri në automjet (AMS, TCS jastëkët me ajër). Kontrollon dhe mirëmban sistemin për frenim, drejtim dhe mbështetje.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Automekanik në industrinë automobilistike ose mund të fillojë biznes personal.


Mekanik i karrocerisë



Mirëmban dhe riparon automjetet e lehta motorike, respektivisht drejtë vlerëson se çka është e nevojshme dhe si duhet të realizohet shmangia e paneleve nga karrocERIA, riparimi i paneleve, e më pas, përsëri bën montimin e komponentëve të karrocerinë së automjetit; Ngjyros automjete, siç janë: automjetet, autobusët ose kamionët, ose vendosë shtresa mbrojtëse të emalit ose llakut mbi pjesët metalike, të drurit dhe prodhimeve të tjera të gatshme, si zakonisht me sprej me dorë. I përgatitë sipërfaqet punuese me shfrytëzimin e metodave të ndryshme për mënjanimin e yndyrave, papastërtive, korrozionit, etj.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Auto-teneqepunues dhe Auto-ngjyrosës në industrinë automobilistike ose nëpërmjet fillimit të biznesit individual.


Montues i motorëve dhe automjeteve motorike



Monton dhe instalojnë pjesë, tërësi dhe sisteme sipas dokumentacionit të dhënë teknik ose sipas instruksioneve punuese, mënjanon parregullsi në procesin e punës në kuadër të kompetencave të tij të dhëna, gjatë kësaj siguron dhe kontrollon kualitetin e punës së kryer sipas kritereve të dhëna, aplikon normativin dhe standardet e punës. Lexon dhe shfrytëzon dokumentacionet teknike – urdhëresat e punës dhe vizatimet teknike. Aplikon rregullat për siguri dhe shëndet gjatë punës dhe masat për mbrojtje të mjedisit jetësorë.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Montues i motorit dhe automjeteve motorike dhe Mekanik dhe montues i motorëve dhe automjeteve motorike në industrinë e automjeteve motorike dhe pjesëve të automjeteve motorike, servisimim për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve motorike, auto-salone, shitore për pjesë rezervë, ndërmarrje me park vozitës, ndërmarrje që realizojnë transport publik të udhëtarëve dhe mallrave, dhe mund të udhëheq edhe biznesin e vetë individual.


Mekanik i makinerisë



Ky kualifikim ka të bëjë me procesin e mirëmbajtjes së veglave të makinerisë, makinave të tekstilit për thurje dhe makinave në ndërtimtari për punë tokësore. Pas mbarimit me sukses të arsimimit, nxënësi do të jetë i aftë për respektimin e rregullave për siguri dhe mbrojtje gjatë punës, shfrytëzimin e dokumentacionit teknik, veglave, pajisjeve, instrumenteve matëse, njohjen e procedurave për kontroll dhe mirëmbajtje të makinave në ndërtimtari dhe tekstil, si dhe veglat makinerike, zbulimin dhe mënjanimin e parregullsive të makinat për thurje dhe qepje, zbulimi dhe mënjanimi i parregullsive të makinat ndërtimore dhe zbulimin dhe mënjanimin e parregullsive të veglat makinerike.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Axhustator ose Mekanik i makinave.


Përpunues i metaleve



Ky kualifikim ka të bëjë me prodhimtarinë e pjesëve makinerike. Kualifikimi i mbulon të gjitha njohuritë e nevojshme, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për punë të suksesshme në industrinë makinerike. Pas mbarimit të shkollimit, nxënësi do të jetë i aftë për: përpunimin e pjesëve me dorë dhe makinë, lidhjen e pjesëve metalike me saldim dhe pikje, përpunimin e pjesëve me deformim plastik, operimin e drejtë dhe mirëmbajtjen e veglave, makinave dhe pajisjeve si dhe planifikimin e punës dhe sigurimin e kushteve për realizimin e saj.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Tornues dhe Frezues.


Instalues për ngrohje dhe klimatizim



Punon elemente dhe nëntërësi për instalimet e ngrohjes qendrore dhe klimatizim; Pret, jep formën dhe lidhë gypa dhe elemente gypore, pjesë nga llamarinat dhe profile, hap filetë, punon fllangje, mbajtës, mbështetës. Operon me vegla për shtërëngim, përpunim, matje dhe kontroll. Monton trupa për ngrohje, kaldaje, aparate, pompa, kompresorë, termostatë, konektorë dhe komponentë të tjera elektrike dhe elektronike sipas vizatimit të dhënë, specifikimit dhe udhëzimit të prodhuesit. Udhëheqë, operon dhe mirëmban pajisje dhe instalime për ngrohje, Përpunon dhe përgatit elemente për klimatizim; Monton elemente për pajisje-klimatike. Monton, udhëheq, operon dhe mirëmban pajisje dhe instalime për ngrohje dhe klimatizim.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Instalues për ngrohje ose Instalues i klimatizimit.


Instalues i gypave të ujit



Vendosë, lidhë dhe mirëmban gypat e ujësjellësit. Vendosë dhe monton instalime sanitare të brendshme dhe të jashtme të ujësjellësit, si dhe tubacione teknologjike. Vendosë dhe lidhë gypat dhe pajisjet e gazit, si dhe tubacionet teknologjike. Monton dhe lidhë konsumues energjetik në sistemin e instalimeve me gypa. Mirëmban instalimet dhe pajisjet e ujit, sanitare, teknologjike dhe të gazit.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Montues i instalimeve të ujit dhe sanitare; Montues i instalimeve të ujit të ngrohtë ose Montues i instalimeve të gazit dhe në vende të tjera pune në industrinë makinerike.

Mekanik i konstruksioneve



Lexon tërësi dhe vizatime montuese. Përgatitë elemente: llamarina, profile, dhe gypa për lidhje në konstruksione dhe ujësjellës. Lidhë konstruksione dhe ujësjellës të ndryshëm me bulona dhe dado. Lidhë elemente në konstruksione dhe ujësjellës me saldim me gaz, hark elektrik, MIG/MAG metodë. Mirëmban konstruksionet dhe shiritat transportues, konstruksione të çatisë, kontejnerë dhe rezervuare. Punon pjesë rezervë dhe elemente konstruktive. Planifikon punën dhe siguron kushte për realizimin e saj. Aplikon standardet për kualitet. Aplikon rregullat për mbrojtje gjatë punës dhe mbrojtje të ambientit.

Me arritjen e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Axhustator ose Mekanik i konstruksioneve.

Teknik i makinerisë për automjete motorike

Mirëmban, servison dhe riparon automjete motorike, por edhe merr pjesë gjatë prodhimit të tyre. Organizon dhe realizon mbikëqyrje mbi mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve motorike, diagnostikon parregullsitë e automjeteve motorike, kontrollon, përshtatë dhe lidhë pjesë dhe sisteme në automjete motorike dhe organizon procedura në procesin prodhues të automjeteve motorike.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Diagnostifikues i parregullsive të automjeti; Mekanik dhe montues i motorit dhe automjetit motorik; Operator i teknologjisë së prodhimit të motorëve dhe automjeteve motorike ose Bashkëpunëtor për dokumentacion teknologjik në makineri, në industrinë e prodhimit të automjeteve motorike dhe pjesëve të motorit, servisim për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve motorike, shërbime teknike, stacione për kontroll teknik, auto-salone, shitore për pjesë rezervë, ndërmarrje për park vozitës, ndërmarrje që realizojnë transport publik të udhëtarëve dhe mallrave, kurse mund të zhvillojë edhe biznes personal.

Përgatitë dokumentacione teknike dhe teknologjike për përpunimin e metaleve me gdhendje (prerje) dhe përpunim plastik. Operon me veglat makinerike. Përpunon konstruksione metalike. Përpunon dhe mirëmban veglat dhe realizon punë me saldim. Operon dhe programin makina CNC. Planifikon, organizon, përcjellë dhe optimalizon punën, zgjidhë probleme, kontrollon kualitetin e veglave, pajisjeve, materialeve dhe prodhimeve, në pajtim me dokumentacionin e projektuar.

Teknik i makinerisë

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Operator i teknologjisë së përpunimit të metaleve me deformim dhe gdhendje; Operator i teknologjisë për përpunimin e konstruksioneve metalike; Vegëltar; Operator i teknologjisë së saldimit; Operator i makinave CNC; Përpilues i CNC programeve dhe Bashkëpunëtor për dokumentacionin teknologjik në makineri, në ndërmarrje që merren me përpunime makinerike me shfrytëzimin e makinave CNC dhe klasike me gdhendje dhe deformim plastik. Mund të punojë në ndërmarrje për punimin dhe montimin e konstruksioneve me dhe pa saldim, përpunimin dhe mirëmbajtjen e veglave, makinave dhe pajisjeve, industrinë përpunuese, industrinë e automobilistike dhe çdo kund ku ka makina dhe stabilimente dhe nevojë për prodhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Teknik i makinerisë energjetike

Udhëheqë me prodhime funksionale, sigurta dhe të qëndrueshme, procese dhe sisteme (PPS) për të plotësuar nevojat e klientëve. Planifikon si i pavarur ose nën mbikëqyrje, përgatitë dhe organizon punën, përpunimin e dokumentacionit teknologjik dhe përpunimin e dokumentacionit administrativ organizativ. Operon, mirëmban dhe udhëheqë me stabilimentet energjetike, makinat dhe pajisjet, paraqitjen dhe servisimin e sistemit për ngrohje dhe klimatizim. Realizon kontrollin e kualitetit dhe kuantitetit të punëve të realizuara dhe përcjellë, kontrollon dhe rregullon parametrat e procesit në stabilimenteve termoenergjetike dhe termoteknike.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Mekanik i stabilimenteve energjetike; Operator i teknologjisë prodhuese dhe mirëmbajtjen e makinave dhe stabilimenteve makinerike; Operatorë për stabilimentet e prodhimit të energjisë; Instalues për ngrohje, klimatizim dhe ventilim me shkathtësi për efikasitet energjetik të objekteve dhe Bashkëpunëtorë për dokumentacion teknik në makineri në kompani që merren me prodhimtari, distribuim dhe furnizim me energji të nxehtësisë, elektrike dhe gaz natyral; në objektet me kalidajë personale (industrinë e proceseve, kalidajë për sistemin e ngrohjes etj.), në kompani që merren me projektimin dhe paraqitjen e sistemit për ngrohje dhe klimatizim, si dhe të udhëheqë biznes personal.

KATËR VITE

Teknik për udhëheqje kompjuterike

Përgatitë dokumentacione teknike dhe teknologjike, për përpunimin e metaleve me gdhendje (prerje) dhe deformim, punimin e programeve për sisteme CNC. Operon me sisteme CNC dhe përpunon prodhimin përfundimtar në sistemet CNC sisteme/makina. Udhëheq me kompjuter sisteme të automatizuara; konfiguron dhe mirëmban sisteme mekatronike. Programon sisteme PLC. Punon me sisteme inteligjente dhe punë industriale. Kualifikimi Teknik për udhëheqje me kompjuter jep mundësi për arritjen e njohurive TIK, shkathtësi dhe kompetenca të aplikueshme në makineri, si dhe në sektorë të tjerë të ngjashëm. Nxënësi pas mbarimit të shkollimit do të mund të organizon, përcjellë dhe të optimalizojë punën, të zgjidhë probleme, të realizojë kontrollin e kualitetit të veglave, pajisjeve, materialeve dhe prodhimeve, në pajtim me dokumentacionin e projektuar. Do të punojë në punë operative në industrinë makinerike ku përdoret udhëheqja kompjuterike. Tekniku për udhëheqje kompjuterike pas mbarimit të arsimit të mesëm do të mund të punojë në ndërmarrjet që merren me përpunimin makinerik duke shfrytëzuar makinat CNC dhe klasike me gdhendje dhe deformim plastik.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Operator i makinave CNC; Krijues i programeve CNC; Operator i teknologjisë së përpunimit të metaleve me deformim dhe gdhendje; Operator i udhëheqjes së sistemeve kompjuterike dhe Bashkëpunëtor i dokumentacionit teknik në makineri në organizata dhe ndërmarrje ku shfrytëzohet udhëheqja kompjuterike dhe mbikëqyrja, siç janë: industria energjetike, ushqimore, kimike, shtypëse, automobilistike, bujqësi, fermat blegtorale, hotele, objekte administrative dhe sportive dhe çdo kund ku shfrytëzohet udhëheqja kompjuterike dhe mbikëqyrja, sistemet e inteligjencës, robotët industrial dhe teknologjia TIK.


KATËR VITE**Teknik për
prodhimtarinë
makinerike**

Përgatitë dokumentacionet teknike dhe teknologjike për përpunimin e metaleve me gdhendje dhe deformim plastik. Operon me veglat makinerike. Përpunon konstruksione metalike. Përpunon dhe mirëmban veglat dhe realizon punë me saldim. Shfrytëzon veglat, makinat dhe pajisjet për përpunimin e prodhimeve nga masat plastike. Operon dhe programon makina CNC. Planifikon, organizon, përcjellë dhe optimalizon punët, zgjidhë probleme, kontrollon kualitetin e veglave, pajisjeve, materialet dhe prodhimet, në përputhje me dokumentacionin projektues. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Operator i teknologjisë së përpunimit të metaleve me deformim dhe gdhendje (prerje); Operator i teknologjisë për përpunimin e konstruksioneve metalike, Vegëltar; Operator i teknologjisë për saldim; Operator i makinave dhe pajisjeve për përpunimin e prodhimeve nga masat plastike; Operator në makinat CNC; Krijues i programeve CNC dhe Bashkëpunëtor për dokumentacione teknologjike në makineri në ndërmarrje që merren me punime makinerike me shfrytëzimin e makinave CNC dhe klasike me gdhendje dhe deformim plastik. Mund të punojë në ndërmarrje për përpunimin dhe montimin e konstruksioneve me dhe pa saldim, përpunon dhe mirëmban veglat, makinat dhe pajisjet, në industrinë përpunuese, industrinë automobilistike dhe çdo kund ku ka makina dhe stabilimente dhe nevojë për prodhimin e tyre dhe mirëmbajtje.

A large white airplane is parked on a tarmac. In the background, there are stacks of shipping containers in various colors (blue, orange, red) and a yellow truck with a white trailer. The scene is set against a clear blue sky.

10


**KOMUNIKACION,
TRANSPORT
DHE DEPOZITIM**



Zgjidhni rrugën tuaj, mos ndiqni rrugën që të gjithë ndjekin - Krijoni rrugën tuaj, në rrugën që të gjithë ndjekin, gjithmonë ka rrëmujë!

Komunikacioni ose transporti është lëvizje e organizuar për njësitë e transportit (mjetet transportuese) në rrjetin e trafikut nga një vend në vend tjetër. Sistemi i komunikacionit bashkëkohor dhe i zhvilluar është i nevojshëm për në të ardhmen. Zhvillimi i komunikacionit ndikon mbi cilësinë e jetës së njerëzve, por edhe mbi zhvillimin e tërësishëm ekonomik të vendit. Fjala komunikacion ose transport, në këtë kontekst, nënkupton bartje (i kryer në komunikacionin rrugor, hekurudhor, ujor, ajror dhe transportet tjera) aktivitete logjistike të kryera para ose pas bartjes ose depozitimi si aktivitetet e veçantë logjistik. **Sektori i komunikacionit, transportit dhe depozitimit aktivitetet e veta i orienton kah organizimi i sistemit transportues funksional, të sigurtë, ekonomik dhe të qëndrueshëm** me qëllim bartjen e udhëtarëve dhe informatave nga një vend në vend tjetër dhe bartja e të mirave materiale nga vendi i krijimit të tyre deri në vendin e konsumimit, respektivisht deri në vendin e asgjësimit (mbarimit) të tyre.

Kualifikimet nga sektori Komunikacion, Transport dhe Depozitim janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMK "Taki Daskallo" – Manastir, ShMK "Bogdanci" -Bogdanci, ShMPK "Kole Nedellkovski" – Veles, ShMK "Vanço Prke" – Vinicë, ShMK "Gosho Vikendiev" – Koçanë, QShEMK "Sh. Naum Ohridski – Ohër, ShMK "Riste Risteski – Riçko"- Prilep, ShMQSH "Vllado Tasevski"- Qyteti i Shkupit," QShA "Boro Petrushevski"- Qyteti i Shkupit, ShMK "Nikolla Karev" – Strumicë, ShMPK "Moshë Pijade" - Tetovë.

**NË
KOHËZGJATE**
**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**
**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**
TRE VITE
**Drejtues i
makinave
për bartjen
e materialit**


Planifikon dhe përgatitë drejtimin (bartjen) e mallit me piruner; kryen kontrollin e rregullsisë së priunerit dhe vinçave; drejton me piruner të gazta, motorike dhe elektrike; respekton rregulla në transportin e brendshëm; drejton vinça-urë, vinça portale dhe gjysmëportale, vinça-konzoll lëvizëse dhe jo lëvizëse, vinça lëvizëse dhe jo lëvizëse me shtyllë ose kullë; kryen depozitimin dhe largimin e materieve të dëmshme ekologjike që të minimalizohen ndikimet negative ndaj mjedisit jetësor.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Drejtues i pirunerit ose Drejtues i vinçave në reparte industriale, ndërtimtari, depo, në hekurudhë ose aeroport.

KATËR VITE
**Teknik i
komunikacionit
hekurudhor**

Planifikon, organizon dhe e rregullon komunikacionin dhe punën manovrike të trenave. Organizon dhe planifikon vendosjen e vagonëve për ngarkim dhe shkarkim. Evidenton arkën e udhëtimit për dhënie e biletave në stacionet ku nuk ka arkëtar udhëtimi. Përpilon dhe kontrollon dokumente. Me telekomandë, me ndihmën e teknikës informatike dhe teknologjike e rregullon komunikacionin e trenave. Bën regjistrimin e trenit dhe përgatitjen e dokumenteve të trenit. Bën punën e kontabilitetit në arkëtimit në stacion dhe në të gjitha arkat e tjera. Kryen kalkulimin dhe pagesën e shpenzimeve transportuese gjatë lidhjes së kontratave për transportin e udhëtarëve, bagazhit dhe mallrave. Harton raporte dhe konkluzione të arkës. Kontrollon dhe siguron prova në bazë së të cilave mund të bëhet vlerësimi i gjendjes

së sigurimit në komunikacion. Bën pranimin e mallit në depo, e ruan atë, udhëheq me mallin në depo dhe e dorëzon me kërkim të kërkuesit. Zbaton rregulla, procedura dhe ligje nga fusha e komunikacionit dhe logjistikës, veçanërisht sigurim gjatë punës dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë si: Drejtues i trenave, Dispeçer me telekomandë, Teknik komercial-transportues, Arkëtar në stacionin hekurudhor, Operator për depozitim, por edhe në vende tjera të punës në kuadër të komunikacionit hekurudhor, në pajtueshmëri me kualifikimin e përvetësuar.

KATËR VITE

Teknik i transportit rrugor

Kontribon për sigurimin në komunikacion, kryen incizim në trafik, përpilon tabela dhe fotografi grafike, rregullon karakteristika teknike në udhëkryqe dhe në sipërfaqe të tjera të komunikacionit, si dhe në sinjalizimin e komunikacionit, vërteton regjimin e trafikut në bazë të metodës adekuate dhe mbanë llogari për sigurimin aktiv dhe pasiv në komunikacion. Organizon, realizon dhe përcjellë procesin transportues gjatë transportit të udhëtarëve dhe ngarkesës në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar. E vërteton rregullsinë teknike të automjeteve dhe e kontrollon rregullsinë e pajisjes obligative të cilën duhet ta posedojë secili automjet. Ndërmerr masa konkrete për ekspertizë të drejtë në ndonjë aksident komunikacioni. Zbaton rregulla, procedura dhe ligje nga sfera e komunikacionit dhe logjistikës, veçanërisht në sigurimin gjatë punës dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator për rregullimin dhe sigurimin në komunikacionin rrugor, Dispeçer në komunikacionin rrugor, Operator për organizimin e komunikacionit rrugor, Operator për eksploatimin të mjeteve rrugore transportuese, Operator për ekspertizë në aksidentet e komunikacionit, Operator për depozitim, si dhe në vende tjera të punës në kuadër të komunikacionit rrugor, në pajtueshmëri me kualifikimin e përvetësuar.

Teknik i transportit dhe shpedicionit

Planifikon, organizon, realizon dhe e përcjellë kryerjen e transportit në rrugën prej vendit të pranimit deri në vendin e dorëzimit të dërgesave; kryen pranimin e mallit në depo, përfshirë edhe ruajtjen e mallit para dhe pas mbarimit të procesit transportues, drejtimin (udhëheqjen) e mallit në depo dhe dërgesën e mallit; kryen punë shpediterike lidhur me transportin dhe përcjelljen e dërgesave dhe koordinimin e të gjithë pjesëmarrësve gjatë transportit të mallit nga një vend në vend tjetër; zbaton formalitete doganore;

Mbledh dhe shqyrton dokumentacionin adekuat për pranim, doganim, transport, si dhe për përgatitjen e mallit, zbaton rregulla, procedura dhe ligje nga fusha e komunikacionit dhe logjistikës, veçanërisht sigurim gjatë punës dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor; punon në pajtueshmëri me ISO standardet.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi do të mund të punojë, si: Operator për transport, Shpediter, Përfaqësues shpediterik doganor, Operator për depozitim si dhe në vende tjera të punës në shpedicion në pajtueshmëri me kualifikimin e përvetësuar, ose nëpërmjet fillimit të biznesit personal.

Teknik i logjistikës në komunikacion

Zbaton teknika për udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha çështjeve transportuese në kuadër të një organizate; kryen obligimet e punës lidhur me ruajtjen e mallit para ose pas kryerjes së procesit transportues në aspekt të pranimit fizik të mallit, udhëheqjen (drejtimin) me mallin, ndarjen, bashkimin, paketimin dhe shënimin, ruajtjen dhe dërgesën e mallit, kryen punë nga sfera e sigurimit në procesin transportues, respektivisht përgatitë dhe përpilon polisa për sigurim, kryen punë të organizatorit special të përgatitjes së të mirave materiale në emër të vet, kurse në llogari të komitentit (klientit) si dhe punë tjera që kanë të bëjnë me transportin, kryen punë shpediterike lidhur me transportin dhe përcjelljen e dërgesave, por paraqitet edhe si koordinator i të gjithë pjesëmarrësve në transportin e mallit nga një vend në vend tjetër, zbaton rregulla, procedura dhe ligje nga sfera e komunikacionit dhe logjistikës, veçanërisht siguri gjatë punës dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.


Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mundet të punojë, si: Operator për transport logjistik, Operator për depozitim, Përfaqësues për sigurim në komunikacion, Shpediter si dhe në vende tjera të punës në shpedicion në pajtueshmëri me kualifikimin e përvetësuar ose nëpërmjet fillimit të biznesit personal.





11

**TEKSTIL, LËKURË
DHE PRODHIME
TË NGJASHME**



**Jeta nuk është e përkryer,
por mund të jetë stili i
Juaj i veshjes!**

Industria e tekstilit dhe lëkurës, paraqet një ndër industritë kryesore të përpunimit në vend, me rezultate të konsiderueshme në formimin e BPV-së, absorbimin e lartë të fuqisë punëtore dhe eksportit. Prodhimtaria e produkteve të tekstilit dhe lëkurës, përkatësisht prodhimtaria e tekstilit, veshmbathjes, lëkurës, si dhe materialeve të riprodhuara, është e një rëndësie të madhe për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Grupet e produkteve më të pranishme në eksportin e industrisë së tekstilit janë: bluzat femërore, këmishët femërore dhe mashkullore, pantallonat, uniformat e punës, xhaketat dhe palltot për meshkuj dhe të ndryshme, përderisa tek industria e lëkurës janë: mbathjet dhe produktet tjera prej lëkure. Industria e lëkurës, në të cilën bën pjesë edhe prodhimtaria primare e lëkurës dhe gëzofit, prodhimtaria e mbathjeve si dhe galanteria nga lëkura.

Kualifikimet nga sektori Tekstil dhe Lëkurë janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMK „Aco Ruskovski”- Berovë, ShMK, „Taki Daskallo”- Manastir, ShMK „Bogdanci” - Bogdanci, ShMK, „Vanço Prke”- Vinicë, ShMK „Metodi Mitevski - Brico”- Dellçevë, ShMK, „Pero Nakov”- Kumanovë, ShMK, „Mile Janevski - Xhingar” - Makedonska Kamenica, ShMK, „Gjorçe Petrov”- Prilep, ShMQSh „Koço Racin”- Shkup, ShMK, „Niko Nestor”- Strugë, ShMK, „Nikolla Karev”- Strumicë, ShMK „Goce Stojçevski”- Tetovë, ShMK, „Dimitar Mirasçiev”- Shtip.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

TRE VITE

Konfeksioner



Bën përzgjedhjen e materialeve themelore dhe ndihmëse, për përpunimin e një produkti konkret të konfeksionit, në pajtueshmëri me urdhrin për punë, konstrukton imazhin e prerjeve, formon shtresë për prerje, bën vendosjen e imazhit të prerjeve mbi shtresën për prerje dhe realizon prerjen, kompletton pjesët e prera, bën përgatitjen e vendit të punës dhe rregullon makinën për qepje, realizon hekurosjen gjatë fazës së ndërmjetme si dhe bën qepjen e pjesëve të prera në veshje.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Rrobaqepës i materialeve të konfeksionit, në vende të ndryshme pune, në pajtueshmëri me kualifikimin përkatës.

KATËR VITE

**Teknik për
përpunimin
e veshjes**

Përgatitë dhe analizon dokumentacionin operativ dhe tekniko-teknologjik, bën përzgjedhjen dhe drejton me makineri dhe mjete adekuate për shtruarjen, prerjen, qepjen dhe përpunimin e veshjeve. Realizon operacionet e prerjes, qepjes dhe përpunimit përfundimtar. Harton normativin dhe çmimin e produktit, organizon, ndjek dhe kontrollon procesin e përpunimit dhe ripërpunimit të veshjeve, përmes operacioneve dhe fazave.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator për prerjen e veshjeve, Operator për qepjen e veshjeve, Operator për përpunimin dhe ripërpunimin e veshjeve, si dhe në vende të ndryshme pune, në pajtueshmëri me kualifikimin përkatës.

Teknik i dizajnit të veshjes

Bën dizajnimin dhe përpunimin e skicave dhe koleksionit të modës, në bazë të rregullave dhe kërkesave të përcaktuara, nga ana e klientëve dhe punëdhënësit. Dizajnon në bazë të idesë personale, apo sipas temës së dhënë, duke aplikuar pothuajse të gjitha fushat artistike. Zbaton principe të ndryshme të kompozimit, në drejtime të ndryshme si dhe harmonisë në funksion të dizajnit. Bën projektimin e ideve artistike, të dizajnit të tekstitit. Vë në pah, reaktivitetin e dizajnit të veshjes, me aplikimin e programeve softuerike, për përgatitjen e imazheve të modës. Përpunon pjesët e prera të veshjeve, kompletimin e tyre dhe modelimin, dekorimin e modelit provë, me dorë apo makinë. Planifikon dhe përgatit, burimet e nevojshme për përpunimin e kompletuar të modelit provë.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Dizajner i veshjes, Stilist mode, Operator për prerjen e veshjeve, Operator për qepjen e veshjeve, Operator për përpunimin dhe ripërpunimin e veshjeve, si dhe në vende të ndryshme pune, në pajtueshmëri me kualifikimin përkatës.

KATËR VITE

Teknik për modelimin e veshjes

Krijon model, përcakton masat me dorë dhe me kompjuter. Vizaton konstruksionin themelor, planifikon dhe përgatit burimet e nevojshme për përpunimin e kompletuar të modelit provë, si dhe realizon punën me anë të sistemeve bashkëkohore CAD dhe CAM. Modelon dhe ndërton, pjesët e prera si dhe bën përpunimin e modelit provë.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Dizajner i veshjes, Operator për prerjen e veshjeve, Operator për qepjen e veshjeve, Operator për përpunimin dhe ripërpunimin e veshjeve, si dhe në vende të ndryshme pune, në pajtueshmëri me kualifikimin përkatës.

Teknik për mbathje

Bën pranimin e materialeve, vendosë në mënyrë të drejtë materialet dhe pajisjet për punë, si dhe bën prerjen dhe klasifikimin e pjesëve të sipërme të mbathjeve. Operon me makinat për përpunim, bën montimin e pjesëve të brendshme dhe të jashtme të mbathjeve si dhe montimin e pjesëve të sipërme dhe të poshtme, deri në produktin final të mbathjeve.

Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Operator për prerjen e mbathjeve, Operator për qepjen e mbathjeve, Ngjitës i pjesëve të sipërme dhe të poshtme të mbathjeve, si dhe në vende të ndryshme pune, në pajtueshmëri me kualifikimin përkatës.

KATËR VITE

Teknik për modelimin e mbathjeve

Kryen përgatitjet në vendin e punës, vizaton dhe konstruktoren mbathje dhe galanteri prej lëkure. Përpunon shabllone (me dorë ose kompjuter) për realizimin e modelit provë. Aplikon makina, vegla dhe mjete, në pajtueshmëri me operacionet teknologjike. Bën prerjen e pjesëve themelore të mbathjeve, përpunon dhe monton me anë të ngjitësit si dhe qep, nga ku përfiton produktin, gjysmë të gatshëm. Ngjitë pjesën e sipërme dhe të poshtme të mbathjeve, si dhe realizon përpunimin e modelit provë. Ndjek të arriturat e reja tekniko-teknologjike dhe tendencat e modës, si dhe bën përgatitjen e koleksionit për promovim.


Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Dizajner i mbathjeve, Modelues i mbathjeve dhe galanterisë nga lëkura, Operator për prerjen e mbathjeve, Operator për qepjen e mbathjeve, Ngjitës i pjesëve të sipërme dhe të poshtme të mbathjeve, si dhe në vende të ndryshme pune, në pajtueshmëri me kualifikimin përkatës.





12

**HOTELERI
DHE TURIZËM**



**Bota është një libër, ata
që nuk udhëtojnë lexojnë
vetëm një faqe!**

Hoteleria është një veprimtari ekonomike që ofron shërbime të ndryshme për njerëzit për të përmbushur nevojat e tyre për akomodim, ushqim, pije, argëtim dhe kohë të lirë. Nëse mirë e vështrojmë procesin teknologjik të punës, do të shohim që hoteleria është një veprimtari e pjesshme shërbimi, respektivisht ajo kryen edhe prodhimtarinë në funksionimin e saj. Përgatitja e ushqimit dhe pijeve ka karakterin e punës prodhuese, kjo bën pjesë në fushën e prodhimit të materialit, ndërsa marrja me qira e dhomave është një shërbim, e kjo ka karakterin e punës jo-prodhuese.

Turizmi është një veprimtari ekonomike që ka lindur si rezultat i lëvizjes masive të njerëzve për të përmbushur nevojat e tyre për pushim dhe rekreacion. Turizmi është një veprimtari shumë specifike ekonomike, për shkak se paraqet përmbledhje veprimtarish të ndryshme që plotësojnë nevojat e konsumatorëve turistikë.

Kualifikimet nga sektori Hoteleri dhe Turizëm janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShPK "Aco Ruskovski" – Berovë, ShPK "Taki Daskallo" – Manastir, ShMPK "Kole Nedellkovski" – Veles, ShMK "Josif Josifovski" – Gjevgjeli, ShMK "Mitko Penxhukliski" – Kratovë, ShMK "Gjorçe Petrov" Kriva Pallankë, ShMK "Naum Naumovski – Borçe" – Krushevë, ShMK "Sh. Naum Ohridski" – Makedonski Brod, ShHTK "Vanço Pitoshevski" – Ohër, ShMQSh "LLazar Tanev" – Shkup, ShMQSh "Shaip Jusuf"- Shkup, ShMK "Niko Nestor"- Strugë, SHMPK "Moshë Pijade" – Tetovë, ShPK "Kole Nehtenin" – Shtip.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

TRE VITE

Kuzhinier




Përgatitë produkte ushqimore për të finalizuar lloje të ndryshme të produkteve të gatuar: meze të ftohta dhe të nxehta, supa, çorbë, salcë, ushqime nga mishi, peshk, gaforre, ushqime deti, ushqime vegjetariane, sallata, produkte ëmbëlsirash, ushqime kombëtare, si dhe ushqime tjera të nevojshme. Shërben, dekoron dhe vendosë ushqimet në enë të përshtatshme, mirëmban dhe azhurnon të dhënat e punës në kuzhinë, punon në përputhje me normat, garanton për punën dhe shërbimin cilësor, si dhe kryen punë në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit të punës dhe ambientit jetësor.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Kuzhinier.

KATËR VITE


Kamerier



Bën punë përgatitore dhe sallatë për shërbim, zbaton kodeksin e veshjes, mirëpret dhe pranon mysafirë, pranon porosi dhe u shërben mysafirëve duke aplikuar teknika të shërbimit në hoteleri, përgatitë dhe shërben pije të hapura, në shishe dhe të përziara, llogaritë shërbimet dhe i dërgon (përcjellë) mysafirët. Punon në përputhje me normat dhe garanton për cilësinë e punës dhe shërbimeve, si dhe kryen punë tjera në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit të punës dhe ambientit jetësor.

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Kamerier.

TRE VITE

**Pastiçier**

Përgatitë dhe kompletton lloje të ndryshme të produkteve ëmbëlsirash sipas recetës, përgatitë dhe dekoron produkte ëmbëlsirash. Pjekë keke dhe parori të llojeve të ndryshme të brumërave dhe masave, përgatitë mbushëse, fille, lyerje, mbështjellje, prodhon parori të freskëta të mbushura, desertë, prodhime të çokollatës dhe lloje të ndryshme të akullores dhe produkteve nga akullorja, Punon në përputhje me normativët dhe garanton për cilësinë në punë dhe shërbime dhe kryen punë tjera në përputhje me dispozitat për mbrojtje në vendin e punës dhe mjedisit.

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Pastiçier.

Teknik i hotelerisë

Kryen detyra dhe shërbime në kuzhinieri dhe hoteleri për të përmbushur kërkesat e klientit. Përpilon plan dhe organizon punën e përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit dhe pijeve, përpilon një ofertë për ushqime dhe pije, përgatitë dhe shërben lloje të ndryshme të ushqimit dhe pijeve.

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Teknik i kuzhinierisë, Teknik për shërbime hotelerike.

KATËR VITE

Teknik i hotelerisë dhe turizmit

Kryen detyrat e një nëpunësi agjencie dhe receptionisti për të përmbushur kërkesat e klientit. Bën rezervimin e shërbimeve dhe programeve softuerike në punën e hotelerisë dhe turizmit, krijon produkte dhe shërbime sipas dëshirës së klientit, kryen detyrat gjatë mirëpritjes, akomodimit dhe dërgimit të mysafirëve në objektin e hotelerisë, si dhe bën llogaritjen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve hotelerike dhe turistike.

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Nëpunës agjencie, Receptionist.

Teknik i hotelerisë për turizëm rural

Kryen aktivitete pune në një objekt hotelierik ose amvisëri të fshatit në lidhje me qëndrimin e turistëve në mjedisin rural. Planifikon rregullimin e plotë të objektit, dhomat e miqve, oborrit, fermën, kopshtin, krijon ofertë dhe llogaritë çmimet për akomodimin dhe ushqimin e mysafirëve, përgatitë dhe shërben ushqim dhe pije, kryen aktivitete promovuese, shitje dhe pagesë të shërbimeve turistike. Gjithashtu, bën kujdesin për produktet bimore dhe blegtorale në amvisëri.

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Operator për turizëm rural.

KATËR VITE

Teknik për evenimente dhe animacione

Kryen detyrat që lidhen me organizimin dhe realizimin e manifestimeve të ndryshme, evenimenteve dhe përmbajtjeve të animacionit, e qëllim të përmbushjes së kërkesave të klientit. Planifikon, krijon dhe organizon evenimente dhe manifestime, si dhe përmbajtje animacioni për të pasuruar qëndrimin e turistëve. Kryen, gjithashtu, aktivitete promovuese, kalkulime të çmimeve dhe rezervimin e shërbimeve.


Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Animator turistik, Teknik për manifestime dhe evenimente.





13

**KIMI DHE
TEKNOLOGJI**



**„ Me formulë nëpërmjet
eksperimentit, përmes
mikroskopit, tek teknologjitë e
reja bashkëkohore!**

Sektori Kimi dhe Teknologji siguron prodhime funksionale, të sigurta, cilësore dhe procese për plotësim të kërkesave dhe nevojave të klientëve dhe mbrojtje të mjedisit jetësor. Sektori është me rëndësi jetike për jetën e njeriut dhe është përgjegjës direkt për krijimin, ndryshimin dhe përmirësimin e mjedisit jetësor. Industria kimike si një ndër industritë kryesore botërore tenton që nëpërmjet rritjes së inovacioneve të siguron procese të prodhimit me të cilat zvogëlohen rreziqet për shëndetin dhe mjedisin jetësor dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Pikërisht për këtë, trendi i sotshëm në sektorin kimiko-teknologjik janë materialet me karakteristika të përmirësuara të cilat do të mund lehtë të fitohen dhe lehtë të riciklohen dhe teknologji të reja të cilat do të kenë ndikim minimal në mjedisin jetësor, gjatë përdorimit optimal të energjisë.

Industria udhëqimore, si pjesë e këtij sektori, e cila merret me prodhimin e ushqimit cilësor për plotësim të nevojave të konsumatorëve, zhvillohet drejt krijimit të prodhimeve funksionale tek të cilët kombinohen karakteristikat nutricioniste dhe farmaceutike.

Kualifikimet nga sektori Kimi dhe Teknologji janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMPK "Dimitrija Çupovski" - Veles, ShMK "Vanço Prke" - Vinicë, ShMTK "Gostivar" - Gostivar, ShMK "Metodija Mitevski Brico" - Delcevo, ShMPK "Kiro Burnaz" - Kumanovë, ShMK "Sh. Kirili dhe Metodi"- Negotinë, ShMK "Orde Çopela"- Prilep, ShMK "Koço Racin" - Sveti Nikollë, ShMQSh "Marija Kiri Sklladovska"- Shkup, ShMQSh "Dimitar Vllahov"- Shkup, ShMK "Niko Nestor"- Strugë, ShMK "Dimitar Vllahov" - Strumicë, ShMTK "Gjoce Stojçeski" - Tetovë.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

DY VITE

Kasap




Punon në ndarjen, prerjen, heqjen e eshtrave dhe kategorizimin e mishit për përpunim dhe shitje; në repartet e kripjes, shëllirimit dhe përgatitjen e lëndëve të para për prodhime të mishit; në repartin për kole, në përpunimin termik, tymosjen e ftohtë, fermentimin dhe tharjen; në shkriren e indeve dhjamore; në ftohje, paketim, tharje dhe mirëmbajtjen e mishit dhe prodhimeve të mishit; në shitjen e mishit dhe prodhimeve të mishit.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit nxënësi mund të punojë në operacionet primare dhe sekondare në thertore, në reparte për përpunimin e mishit dhe prodhimeve të mishit dhe në shitore për shitje të mishit dhe prodhimeve të mishit.

TRE VITE


Furrtar



Saktë vepron me brumin gjatë mbrujtjes dhe përpunimit, kryen operacione të punës në proceset teknologjike për përpunim të prodhimeve të ndryshme të brumit, trajton, ruan dhe depoziton prodhimet e brumit, trajton dhe i mirëmban mjetet, aparatet dhe pajisjet për procesin e prodhimit. E planifikon punën dhe siguron kushte për kryerjen e të njëjtës. Zbaton standarde me anë të të cilave kontrollohet cilësia dhe korrektësia e sigurisë së brumit dhe prodhimeve të brumit. Komunikon me kolegët dhe mbikëqyrësit.


Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Furrtar për prodhim të bukës, Furrtar për prodhim të brumërave dhe picave, Prodhues i byreku, brumit sfoliat dhe piteve, Furrtar për prodhim të petave, jufkave

dhe kadaifit, por edhe në vende të tjera të punës, në industrinë e brumërave, furra, piceri, byrektore, restorante klasike dhe restorante të specializuara për prodhime të brumit tradicionale.



Përpunues i qumështit

Kryen operacione të punës në procesin teknologjik për përpunim të qumështit në prodhime qumështore të ndryshme, me korrektësi, sipas standardeve, vepron me qumështin gjatë marrjes (përfitimit) së tij, bën dërgesën dhe pranimin në kapacitete përpunuese dhe me korrektësi, sipas standardeve, trajton, kujdeset dhe depoziton qumështin dhe prodhimet e qumështit. Zbaton standarde me anë të të cilave kontrollohet cilësia dhe korrektësia e sigurisë së qumështit dhe prodhimeve të qumështit. Komunikon me bashkëpunëtorët, klientët dhe mbikëqyrësit. Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi do të mund të punojë, si: Bulmetor në fermë, Prodhues i qumështit, Prodhues i prodhimeve të tharta qumështore, Prodhues i gjalpfit, Prodhues i djathit, si dhe në vende tjera pune në industrinë e përpunimit të qumështit, fermat e qumështit ose shitore të specializuara për prodhime të qumështit.



Përpunues i mishit

Punon në industrinë e përfitimit/trajtimin dhe përpunimit të mishit, në prodhime të mishit të freskëta, si dhe shitjen e mishit dhe lloje të ndryshme të prodhimeve të mishit.

Është i aftë të kryen operacione të punës në procesin teknologjik për përpunimin e mishit në prodhimet e ndryshme të freskëta të mishit, kryen përpunim primar të mishit, përpunim të mishit dhe prodhimeve të mishit për prodhim dhe trajtim, ruajtje dhe depozimit të mishit dhe prodhimeve të mishit . trajton dhe i mirëmban mjetet, aparatet dhe pajisjet për procesin e prodhimit të prodhimeve të mishit të freskëta. Zbaton standarde me anë të të cilave kontrollohet cilësia dhe korrektësia e sigurisë së mishit dhe prodhimeve të mishit. Komunikon me bashkëpunëtorët, klientët dhe mbikëqyrësit.

TRE VITE

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi do të mund të punojë, si: Përpunues i mishit, Përpunues - shitës i mishit dhe prodhimeve të mishit, Prodhues i prodhimeve të freskëta të mishit, Prodhues i prodhimeve të mishit të pasterizuara, Prodhues i prodhimeve të mishit të sterilizuara, Prodhues i prodhimeve të mishit afatgjate dhe në vende të punës të tjera nga sfera e përpunimit të mishit.

**Teknik i
prodhimeve
kimike dhe
kozmetike**

Kryen përgatitje individuale dhe përgatitje të vendit të punës me zbatim të parimeve dhe standardeve të vendit të punës, përzgjedhë mjetin përkatës dhe instrumentet për punë, e ndjek dhe e kontrollon procesin teknologjik të prodhimit të prodhimeve kimike dhe kozmetike, siguron kushte për kryerjen e vazhdueshme të punës, kryen analiza dhe hulumtim të përmbajtjes, vetive dhe ndikimit të lëndëve të para, gjysmëprodhimet dhe prodhimet e gatshme kimike dhe kozmetike, përzgjedh ambalazh përkatës për prodhimet.

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi do të mund të punojë në sferën e prodhimit, kontrollit dhe analizimit të prodhimeve kozmetike, si: Operator në industrinë kozmetike, Operator në industrinë e detergjenteve, Operator në industrinë organike- polimere, Operator në industrinë inorganike, Kontrollor i cilësisë së prodhimeve dhe materialeve, Operator i procesit kimik, Drejtues i makinave për ambalazhim, paketim dhe etiketim, por edhe në vende të tjera të punës në industrinë e prodhimit të prodhimeve kimike dhe kozmetike .

KATËR VITE

**Teknik për mbrojtjen
e mjedisit jetësor**

Kryen përgatitjen personale dhe përgatitjen e vendit të punës me zbatim të parimeve dhe standardeve për punë, përgatitë materialin e nevojshëm për analiza konkrete, kryen analiza fiziko-kimike të mostrave të ndryshme (ujë, ajër dhe tokë), kryen analizë mikrobiologjike të mostrave me prejardhje të ndryshme, analizon mbeturinat dhe materiet e rrezikshme.

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi do të mund të punojë në laboratorin për mjedisin jetësor, ndërmarrje për menaxhimin me mbeturina, në stacionet e pastrimit në proceset e prodhimit dhe në terren si Kontrollor i mbeturinave dhe materieve të rrezikshme, Kontrollor i gazrave të emituara nga burime stacionare, Operator për analiza mikrobiologjike dhe sanitare, Kontrollor i cilësisë së ujit, por edhe në vende të tjera të punës të kësaj sfere.

Teknik laborant kimie

Kryen përgatitje personale dhe përgatitje të vendit të punës me zbatim të parimeve dhe standardeve të vendit të punës, bën analizë senzorigje dhe cilësore të mostrës (ujë, ajër, tokë, lëndë të para dhe gjysmëprodhime, prodhime të gatshme (nga industria ushqimore, inorganike dhe organike), kryen analiza sasiore të lëndëve të para, kryen punë të thjeshta rutinore në terren dhe në procesin e prodhimit, llogaritë dhe përpunon të dhëna të fituara nga hulumtimet e kryera kimike.

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi do të mund të punojë në punë operative në laboratorin kimik, si: Kontrollor i depos dhe materieve të rrezikshme, Kontrollor i gazrave të emituara nga burime stacionare, Kontrollor i cilësisë së prodhimeve dhe materialeve, Operator i analizave kimike, Kontrollor i cilësisë së ujit, Operator i procesit- kimik si dhe në vende të tjera pune nga sfera e ndërmarrjeve tregtare të cilat merren me përpunimin dhe prodhimin e prodhimeve ushqimore, barnave, mjetet kimike bujqësore, mjetet kozmetike, letra, lëndë djegëse, detergjente dhe të ngjashme, personat fizik dhe juridik të cilët merren me veprimtari shkencore- kërkimore, laboratorë kimik.

Teknik i ushqimit

Kryen përgatitjen personale dhe përgatitjen e vendit të punës me zbatim të parimeve dhe standardeve të vendit të punës, vlerëson dhe kontrollon cilësinë e lëndëve të para gjysmëprodhimeve, prodhimeve dhe ambalazhit; menaxhon me makina dhe pajisje me ndihmën e të cilave e udhëheq procesin teknologjik, ndjek, kontrollon dhe kryen operacione të caktuara teknologjike në industrinë ushqimore dhe kryen kontroll të brendshëm, kryen praktik të mirë higjienike dhe prodhuese.

Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi do të mund të punojë, si: Përpunues i drithit / Mullixhi, Prodhues i prodhimeve konditore / Konditor, Përpunues i pemëve dhe perimeve, Prodhues i pijeve joalkoolike dhe alkoolike, Prodhues i birrës dhe uthullës, Prodhues i sheqerit, Prodhues i farës së bukës dhe etanolit, Prodhues i kafes, çajit dhe shtojcave të ushqimit, Prodhues i qumështit dhe prodhimeve qumështore, Përpunues i mishit dhe prodhimeve të mishit, Përpunues i bukës dhe brumërave, Operator për analiza mikrobiologjike dhe sanitare, Kontrollor i cilësisë së prodhimeve dhe materialeve, Operator i procesit kimik, trajtues i makinave për ambalazhim, paketim dhe etiketim, por edhe në vende të tjera të punës në industrinë e prodhimit, laboratorin dhe në tregtinë me ushqim.



14

**PYLLTARI
DHE PËRPUNIMI
I DRURIT**

Ju mund të bëni një anije nga druri, mund të ndërtoni edhe shtëpinë tuaj. Mësoni dhe tregoni!

Pylltaria është një degë ekonomike që merret me studimin e pyjeve dhe mënyrën e administrimit të pyjeve dhe burimeve të tjera natyrore që lidhen me to. Pyjet me ripërtëritjen natyrore, strukturën natyrore, përbërjen e përzier dhe ripërtëritjen në moshë të re janë një nga burimet kryesore në RMV tani dhe në të ardhmen. Pozicioni i favorshëm gjeografik i vendit tonë dhe ndikimi i klimës së moderuar mesdhetare dhe kontinentale, favorizon përbërjen e një game të gjerë të sipërfaqeve pyjore me mbi 319 lloje të drurëve dhe shkurreve, me më shumë se 80 specie dhe varietete brenda 119 gjinive dhe 54 familjeve. Llojet kryesore të drurëve në zonën tonë janë: selvia, bredhi, lisi, pisha e bardhë dhe e zezë, ahu, shkurret dhe një përqindje më e vogël e fletorëve dhe drurëve frutorë. Përbërja e këtyre llojeve të drurëve kërkon nga ekspertët, specialistët pyjorë dhe një gamë të gjerë të njohurive mbi zhvillimin dhe menaxhimin e këtyre specieveve, me qëllim ruajtjen dhe forcimin e fondit pyjor. Pema është një material natyral, i gjallë, që është i ngurtë dhe në të njëjtën kohë elastik. Lloji, origjina dhe rritja e tij, përcaktojnë vetitë e tij. Përdorimi i tij është shumë i gjerë. Nën duart e një punëtori me përvojë, druri tregon gjithë bukurinë e tij. Gjatë përpunimit sipërfaqësor të drurit, dhënies së formës dhe montimit të tij përdoren metoda të ndryshme. Druri është një material që shpesh mund të kombinohet me plastike, metal, tekstile dhe lëkurë. Por druri mund të përdoret, gjithashtu, pas përpunimit të ashpër siç është në ndërtim. Disa nga operacionet e punës janë: sharrimi, nxjerrja në plan, zumparimi, profilimi, gozhdimi, montimi, etj. Në këtë familje të këtij profesioni, ka shtatë profesione. Le t'i njohim ata!

Kualifikimet nga sektori Pylltari dhe Përpunimi i drurit janë të përfshira në këto shkolla të mesme profesionale: ShMK „Aco Ruskovski” – Berovë, ShMK „Krste P Misirkov” – Demir Hisar, ShMBPK „Gjorçe Petrov” – Kavadar, ShMK „Gjorçe Petrov” – Prilep, ShMQSh „Gjorgji Dimitrov” – Qyteti i Shkupit, ShMK „Nikolla Karev” – Strumicë, SHMPK „Moshja Pijade” – Tetovë.


**NË
KOHËZGJATE**

**EMËRTIMI I
KUALIFIKIMEVE**

**PËRSHKRIMI I KUALIFIKIMIT
DHE SFERAT E PUNËSIMIT**

**TRE
VITE**


Zdrukthëtar



Pret, jep forma, mbledh dhe riparon objekte druri ose punon dhe administron me shumë lloje të makinave të përpunimit të drurit, të tilla si sharre elektrike, plane, freza dhe makineritë e përpunimit të drurit për të lëmuar sipërfaqen, sharron lëndë druri për të prodhuar produkte druri. Prodhon elemente, struktura, produkte gjysmë të gatshme dhe produkte të gatshme druri dhe i monton dritare dhe dyer PVC, dyer dhe dritare dru-alumin duke përdorur vegla, mjete zdrukthëtarie dhe lloje të mjeteve elektrike të zdrukthëtarisë.

Me përvetësimin (arritjen) e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Zdrukthëtar (marangoz) për mobilie dhe enterier, Zdrukthëtar për ndërtim zdrukthëtarie.


Pylltar



Monitoron, mbron, rregullon dhe shfrytëzon pyjet. Inspekton drurët, shënon ato për prerje, mbjell fidanë të rinj, shënimin për prerje (damkimin), pret drurë, ngarkimin e lëndës drusore për transport dhe punë të tjera. Pylltarët mbledhin fara dhe punojnë për rritjen e llojeve të ndryshme të fidanëve të drurëve pyjore. Gjithashtu, monitorojnë zhvillimin e tyre dhe ndjekin mundësinë për shfaqje të sëmundjeve dhe dëmtuesve. Pylltarët propozojnë dhe marrin masa për të mbrojtur fidanët, si dhe sipërfaqet pyjore në përgjithësi. Prodhuesit e produkteve primare dhe kryesore të drurit janë të punësuar në fabrikat e përpunimit të drurit dhe punëtoritë e zanatit. Me përvetësimin e kualifikimit, nxënësi mund të punojë, si: Pylltar.

TRE VITE

Tapicier



Prodhon, riparon ose zëvendëson tapiceri mobiliesh; Restauron vepra antikitetesh të vlefshme; Qep materiale tapiceri; Përpunon dru, objekte të përpunimit të drurit dhe pllaka me zdrukth dore dhe makina të thjeshta; Përgatitë modele dhe lloje skicash për tapiceri; qep pëlhura shtofi dhe materiale të tjera tapicerie; Mbështjellë pjesë standarde të mobilieve, paneleve të mureve dhe të ngjashme. Me përvetësimin e kualifikimit, ai mund të punojë, si: Tapicier në kapacitetin prodhues të një punëdhënësi ose si një sipërmarrës i pavarur.

KATËR VITE

Teknik për mobilie dhe enterier

Kryen detyra në fushën e prodhimit të mobilieve, modelimit të brendshëm dhe zdrukthëtarisë. Përgatitë dokumentacionin tekniko-teknologjik; përgatitjen operacionale të prodhimit dhe standardizimin e punës; përgatitë dhe klasifikon drurin, dërrasa druri dhe materiale ndihmëse. Prodhon shabllone, bazament tapicerie, panele muri, mbulesa për tavane ose mbulesa mobiliesh dhe instalimin e tyre; qepje të materialeve të tapicerisë; monton produkte të gatshme dhe produkte gjysmë të gatshme; mirëmban, kontrollon dhe riparon produktet; llogaritë çmimin e produkteve të planifikuara dhe shitjen e produktit të përfunduar; prodhon elemente, konstruksione, produkte gjysmë të gatshme dhe produkte të gatshme nga grupe mobiliesh, zdrukthëtari dhe produkte specialiteti. Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Operator i përgatitjes së prodhimit, Operator me procese teknologjike të përpunimit të drurit dhe pllakave të drurit, Operator për fabrikimin e pjesëve të buta të mobilieve dhe dekorimin e brendshëm (enterierit).

Teknik i pylltarisë

Planifikon dhe organizon mbikëqyrjen e prodhimit të materialit mbjellës për pyllëzime; mbledh materiale riprodhuese pyjore dhe produkte dytësore pyjore; gjatë përpunimit dhe ruajtjes së farave, marrjes dhe pikimit të prerjeve. Merr pjesë në ekzaminimin e cilësisë së farave dhe mirëmbajtjes së kulturave pyjore. Zbaton masa parandaluese dhe obligative zbatuese për mbrojtjen e bimëve; llogaritë masën e drurit, trungut të drurit; kryeson me grupin e punës kundër zjarrit në pyje; përdorë instrumente të ndryshme matëse dhe instrumente gjeodezike, masa dhe mjete ndihmëse për menaxhimin e pyjeve; ruan kafshë të egra; organizon dhe administron pastrimin, prerjen, shpërndarjen e produkteve prej druri; vëzhgon shërbimin diagnostikues-propagandistik për mbrojtjen e pyjeve; Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Operator i pyllëzimit dhe mbrojtjes së pyjeve, Operator i prodhimit të pyjeve.

KATËR VITE

Teknik i dizajnit të peizazhit

Planifikon dhe organizon punë në prodhimin e dendromaterialeve dhe bimëve zbukuroese; mbledh dhe mirëmban farat dhe prerjet; përgatitë sipërfaqet për mbjellje, rimbjellë, shartim, kultivim dhe monitorim të gjendjes shëndetësore të materialit mbjellës; identifikon dhe parandalon sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve; hartimin dhe zbatimin e projekteve të gjelbërimit të ambientit mjedisor; rregullon dhe zbukuron sipërfaqet e gjelbëruara; siguron transport për mbjelljen e fidanëve; shënon markon fidanë për shartim ose prerje; administron makineri dhe mjete për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta; kujdeset për materialet, furnizimet dhe punëtorët e terrenit, regjistron të ardhurat ditore dhe fondet e shpenzuara. Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Operator për projektim, realizim dhe mirëmbajtje të sipërfaqeve të gjelbërta, Operator i prodhimit të materialit mbjellës.

Teknik i përpunimit të drurit

Përgatitë dokumentacionin tekniko-teknologjik; bën pranimin, klasifikimin dhe magazinimin e materialit; imprenjimin e drurit dhe prodhimin e lëndës së sharruar; cakton regjimin e tharjes, drejton dhe kontrollon procesin e tharjes; përgatitë, organizon dhe kontrollon cilësinë e tharjes dhe avullimit të drurit; operon makina për nxjerrje në trashësi si lëndë e sharruar në gatër dhe sharrë shirit, për të bërë dërrasa, pllaka druri rimeso; llogaritë koston e produkteve të planifikuara dhe shitjen e produktit të përfunduar. Me përvetësimin e kualifikimit nxënësi mund të punojë, si: Operator me pajisje si fura tharëse dhe imprenjuese të drurit, Operator për prodhimin e pllakave të drurit, Operator në makinat e sharrimit dhe nxjerrjes në trashësi të drurit.





Центар за стручно
образование и обука



Образование за вработување
во Северна Македонија

Shpresojmë që nëpërmjet përmbajtjeve të përfshira në këtë Udhëzues, kemi arritur që të paraqesim denjësisht arsimin profesional, si pjesë e sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mundësitë që i ofron, nivelet dhe llojet e arsimit profesional, sektorët/drejtimit në arsimin profesional, kualifikimet dhe mundësitë për punësim, shkollat e mesme profesionale në të cilat janë të përfshira kualifikimet e sektorëve dhe informacione tjera që do t'ju shërbejnë. Për më tepër informacione për arsimin profesional, shkollat profesionale, kualifikimet në arsimin profesional dhe për profesionet mund të gjeni në ueb-faqet e mëposhtme:

për arsimin profesional:

<http://csoo.edu.mk/sq/faqe-hyrese/per-qapt-in/>

lista e shkollave të mesme profesionale:

<http://csoo.edu.mk/images/stories/lista%20na%20sredni%20ucilista.pdf>

për kualifikimet:

<http://mrk.mk/?lang=mk>

për profesionet:

<https://zanimanja.mk/>

Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim i shpreh mirënjohje Projektit "Arsim për punësim në Maqedoninë e Veriut, „EE@mk" për ndihmën e ofruar në përpilimin e këtij Udhëzuesi, mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, ndërsa i zbatuar nga HELVETAC Maqedonia e Veriut, Qendra Maqedonase për Arsim Qytetar dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë.

